Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. (6)26. QERSHOR 2008. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DINARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP
PROJEKTIM - ZBATIM
koha kalon, cilësia mbetet
Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

REPORTAZH

Pasuria njerëzore e Bulqizës

NGA: **VIRON KONA - FAQE 8**

KULTURË

"Fjala priu...", një libër nga Xhafer Martini

FAQE 13

SHËNIME

Kur kërcejnë dibranët, bëhen mbretër...

NGA: **ABDURAHIM ASHIKU - FAQE 9**

TRADITE

Në gjurmët e baladës së Rexhës...

NGA: **JAHE DELIA (SELMANI) - FAQE 15**

KUMTESE

Fisnikëria dibrane

Nga: **Dr. LAURANT BICA**

Dibra është një nga qytetet më të vjetër të truallit arbëror. Të paktën ajo numëron një qytetari 2000 vjeçare dhe manifeston një qytetërim të spikatur. Asnjëherë nuk është ndërprerë jeta e këtij qyteti të Shqipërisë Lindore ndër shekuj. Gjithashtu ajo shquhet dhe për një fisnikëri të rrënjës dhe të mirënjohur. Por më mirë për jetën e vazhduar të këtij qytet dhe për elitën e tij, q sundoi ndër shekuj atë q u quajt Principata e Dibrës, le t'ua lëmë fjalën të huajve.

Dibra për herë të parë figuron në hartën e gjeografit të shquar të lashtësisë Klaud Ptolemeut të shekullit të dytë të erës sonë, me emrin Deburus. Ajo numërohet si një nga qytetet e vjetër të banuar pa ndërprerje nga shqiptarët dhe ruan një populsi të mirëfilltë qytetare. Në epokën e Skënderbeut krahina e madhe që përfshinte, thirrej Principata e Dibrës. Në vitin 1502 një i huaj, Feliks Petani, i referohet Dibrës (Dibri) si qytet me shumë banorë dhe n'atë kohë ajo njihej si një qendër e rëndësishme qytetare. Gjeografi osman Haxhi Kallfa thotë se shtrihet ndërmjet qyteteve të Ohrit, Kërçovës e Tetovës dhe cakun e "Dibrit", sipas tij e ven 17 ditë larg nga Stambolli. Pukëvili, tre shekuj më vonë, na bën me dije se ndryshe nga mjaft qytete të tjera, elementi sllav aty mungonte fare. Për francezin tjetër Ami Bue, populli i Dibrës është "i vyeshëm", me vlera. Dibrën e Madhe, për ndërtesat e bukura të ndërtuara nga duart e mjeshtërve vendës, një arkitekt i huaj e cilësonte "Stambolli i Vogël"...

Termin fisnikëri ne do ta përdorim në dy kuptime: - së pari, duke pasur parasysh me të një klasë apo më mirë të themi një shtresë të caktuar shoqërore të mesjetës së zgjatur feudale shqiptare; - dhe së dyti, në kuptimin e fisnikërisë si një virtyt moral që ka karakterizuar Dibrën si qytet e krahinë dhe shqiptarët në përgjithësi të kësaj treve, gjithashtu dhe shtresën e fisme, elitën fisnike të qytetit dhe të Nënte maleve të këtyre anëve.

(Vijon në faqen 5)

"Dibra me sytë e të huajve"

*Shoqata "***Lidhja e Intelektualëve Dibranë***" organizon në Tiranë sesion shkencor. Marrin pjesë intelektualë e studiues nga Dibra dhe trevat e tjera shqiptare. Prezantohet libri i* **Agron Tufës**

Faqe 3



Në foto:Pjesëmarrës në simpoziumin shkencor "Dibra me sytë e të huajve", 13 qershor 2008

"Dibra do të dijë të mbetet përherë Universitet"

Fjala e kryetarit të LID, Prof.Dr. Nuri Abdiu - FAQE 2

Artemisa Repa, sopranoja dibrane që ka pushtuar skenën europiane

FAQE 16

Një histori poetike për mbijetesën e genit të lirë

Rreth librit "Qëndresa" të Enver Kaloshit

NGA **DUKAGJIN HATA - FAQE 12**

ARKEOLOGJI

Harta arkeologjike e Çidhnës

Nga: Prof.asoc.dr. **ADEM BUNGURI**

(Pjesa e dytë - Faqe 6)

AKTUALITET

Shkatërrimtarët e Dibrës së Madhe

Nga: **REXHEP TORTE** - Faqe 4

INTERVISTË

Ibrahim Kolari: Investimi në vendlindje më lumturon

Faqe 7

ARSIM

Gjurmëve të dijes

Nga: **BASHKIM FRANGU** - Faqe 7

DËSHMI

Mirto Qormemeti, robi i fundit i Luftës së Dytë Botërore

Nga: **ATLI DEMA** - Faqe 14

Julian Emeri (Ameri): **"Dibra ishte veçanërisht shumë interesante. Unë kam studiuar në Oksford. Por Dibra ishte për mua një universitet tjetër, më i rëndësishëm. Në Dibër mësuam politike më tepër se kudo..."**

"Dibra do të dijë të mbetet përherë Universitet"

Fjala e kryetarit të LID, **Prof.Dr. Nuri Abdiu**, mbajtur në Sesionin Shkencor "Dibra me sytë e të huajve"

"Dibra jonë me historinë e saj, me gjuhën dhe dialektin, folklorin dhe të folmen e saj karakteristike, me gjeografinë dhe konfiguracionin, me etnokulturën dhe etnopsikologjinë e saj, me burimet, veçoritë e saj ekonomike dhe modalitetet e mjeshtërisë e shfrytëzimit të tyre. Veçmas, Dibra me mençurinë e saj karakteristike, Dibra e nëntë maleve, shtatë teqeve, shumë xhamive, kishave dhe vlerave të tjera unikale të saj, ka joshur e tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve të vendeve të ndryshme të botës, që nga shekulli V p.e.s, kur historiani i Greqisë së lashtë Herodoti përmend fisin e doberëve (dmth të dibranëve) e deri te misionarët anglezë Rexhinald Hiberti, Julian Emeri, etj., që kaluan nëpër shumë vise të Dibrës gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Edhe Dibra, kjo nënë e rreptë trimash, madje trimash të mençur e të ditur, ashtu si shumë treva të tjera shqiptare, ka qenë gjithnjë vlera e kërkuar, për njohjen dhe fitimin e së cilës janë përpjekur shumë burrë të ditur të kombeve të huaja.

Shpresa e njohjes dhe më pas e zotërimit të saj, jo rrallë ka ngjallur ambiciet dhe ka ndezur zilitë e tyre, të cilat kanë pasur deri në përpjekjet e vazhdueshme në lëmin e tregtisë, të diplomacisë dhe deri në luftë për të siguruar pushtimin e saj.

Fati i një territori me rëndësi strategjike e vlera të tjera... si Dibra, në të cilën banorët e maleve përmes shekujve kanë qenë mbrojtur nga natyra e thyer dhe e ashpër e truallit të tyre, nuk kish si të mos u interesonte dhe të mos ishte forcë tërheqëse për studiues, arkeologë, gazetarë, etnografë, e të tjerë, vizitorë nga shumë vende të Evropës e më gjerë.

Të gjitha ata që kaluan nëpër Dibër e që ishin jo pak, por disa dhe që vinin nga Gjermania, Austria, Italia, Serbia, Hungaria, Franca, Anglia,



Rusia, Bullgaria, vendet e Lindjes së Mesme, etj., nuk i solli rastësia, nuk kaluan nëpër vendin tonë dhe nuk u fokusuan në Dibër për "tebdil hava", si i thonë fjalës, por për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave që u ishin ngarkuar.

Shumë prej tyre vëzhguan e hulumtuan me mençuri, aftësitë dhe virtyt dibrane, trimërinë, zgjuarsinë e mprehtësinë e tyre që shpalosej, veçmas odave e sofrave, kuvendeve e takimeve, në festa, dasma e morte, në ditë besëlidhjesh e falje gjaqesh.

Ata i testuan dibranët dhe, në përgjithësi i vlerësuan, me dashamirësi e objektivitet.

Madje, mjeshtërisht, shënuan e përshkruan, përgjithësuan me vërtetësi dhe botuan e pasqyruan në veprat e tyre gjithçka që panë, perceptuan, konceptuan e interpretuan, natyrisht, secili sipas profesionit, prirjeve dhe interesave të tyre intelektuale, për studime të ndryshme gjuhësore, ekonomike, sociale, etnografike, etnopsikologjike, etj.

Përfitoj nga ky rast, që në emër të LID, në shenjë mirënjohjeje të thellë e të përhershme, t'u shpreh ndjenjat e konsideratës së lartë dhe nderim të veçantë kujtimit të të gjithë atyre udhëtarëve misionarë, studiuesve specialistë të fushave të ndryshme, që në vëzhgimet e botimet e tyre, pasqyruan drejt dhe saktë gjithçka që panë (dhe prekën) në Dibër me sytë e tyre dhe për gjithçka që ata mësuan prej odave auditorë të "Universitetit" dibran dhe prej "ojnave" e ojnakëve, dhe prej gjithë hapësirës gjeo dhe etnokulturore ekzotike dibrane.

Dibra do të dijë të mbetet përherë Universitet për të huajt, tamam ashtu siç e ka cilësuar z.Julian Emeri (Ameri), i deleguari i Qeverisë Angleze gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, i cili, në një intervistë dhënë në RTSH, me 1 tetor 1991, ndër të tjera është shprehur: "Dibra ishte veçanërisht shumë interesante. Unë kam studiuar në Oksford. Por Dibra ishte për mua një universitet tjetër, më i rëndësishëm. Në Dibër mësuam politike më tepër se kudo..."

Në përgjithësi, dibranët, sipas tyre, ashtu si dhe bashkëkombas të tjerë, kanë treguar gjatë gjithë jetës se janë të zotët, edhe me kordhë, edhe me penë, edhe me trimëri, edhe me mend e me dituri. Dibra ka nxjerrë shumë njerëz të shquar e me nam të madh.

Pikërisht për këtë, në jubileun e dytë të veprimtarisë së saj, Shoqata jonë LID, e shtyrë nga ndjenja e përgjegjësisë dhe vetëdija profesionale, për të pasqyruar në mënyrë sa më të plotë edhe këtë tablo të kontributit të dibranëve në zhvillimet historike-kulturore mbarëshqiptare, për të nxjerrë në pah disa nga veçantitë, specifikat e historisë, kulturës dhe trashëgimisë etnokulturore të kësaj treve, organizon sot këtë sesion shkencor me temë: "Dibra me sytë e të huajve".

Në këtë sesion ne synojmë që të krijojmë edhe një lidhje e komunikim sa më të ngushtë e cilësor midis brezave të ndryshëm të dibranëve, kudo që ata jetojnë e punojnë në kushtet e globalizimit bashkëkohor.

E veçanta e këtij sesioni është përpjekja e bërë, që rikrijimin e imazhit të Dibrës dhe të dibranëve, mendësive dhe kulturës së saj ta bëjmë në mënyrë sa më të paanshme, duke lënë që ta flasin dokumentet dhe studimet e jodibranëve dhe të të huajve.

Të nderuar pjesëmarrës! Veprimtaria që zhvillojmë sot dhe pjesëmarrja në të dëshmon se ne të gjithë e shohim Dibrën nënë edhe me sytë tanë, me sytë e dibranëve.

Organizimi i këtij sesioni, që përbën një veprimtari serioze, nuk mund të realizohej pa ndihmën e madhe të biznesmenëve dibranë që kanë sponsorizuar përgatitjen dhe mbajtjen e tij. Nuk mund të realizohej dhe pa ndihmën e specialistëve që përgatitën kumtesat, historianëve, antropologëve, etnologëve, filozofëve, muzikologëve, gjuhëtarëve të njohur e të tjerë. Të gjithë këta i falënderojmë thellësisht për ndihmën bujare dhe për punën cilësore që kanë bërë."

PREZANTOHET LIBRI: "DIBRA ME SYTE E TE HUAJVE" I AGRON TUFES

Në këtë skicë paraqitëse, kryesisht të karakterit kulturologjik, e cila nuk pretendon të polemizojë me asnjë studiues të historisë, arkeologjisë apo etnokulturës, u munduam të japim një panoramë spontane mbi disa kategori thelbësore që cekin disa veçori historike e etnokulturore të Dibrës, kryesisht duke u mbështetur tek burime të botuara, interpretime apo dorëshkrime dokumentale. U kemi kushtuar rëndësi disa aspekteve nga antikiteti, mesjeta dhe burimeve që dëshmojnë identitetin e veçantë historik e kulturor të Dibrës dhe dibranëve, kontributit të tyre në historinë e përbashkët mbarëshqiptare, ndonëse paraqitjen e tyre e kemi sjellë në mënyre eklektike, pasi autori nuk pretendon që anën e tij të fortë shkencore të ketë profesionin e historianit. Vetë interesimi për historinë, shkencat dhe metodologjitë e saj, autori i sheh si pjesë të pandara të antropologjisë kulturore dhe në tërësi, kulturofilozofisë.

Nuk kemi vazhduar me Kohën e Re, pasqyrimin e kryengritjeve shqiptare pas vdekjes së Skënderbeut, rezistencën dhe përpjekjet e dibranëve për pavarësinë e vendit, luftrat kundër okupatorëve etj., duke iu bashkuar lëvizjeve atdhetare në kontekstin e përgjithshëm të situatave historike, pasi për këto periudha ekziston një dokumentacion historik që përshkruan hollësishëm çdo periudhë. Kemi



Kopertina e librit "Dibra me sytë e të huajve"
Botimet "m&b". ISBN: 978-99956-04-12-7
Çmimi: 1000 lekë

lënë pa përmendur luftërat më të tmerrshme, fillikate e të vetmuara të dibranëve kundër invazioneve serbe, për të njëjtat arsye, duke u kufizuar me këtë etyd hyrës, në cilësinë e guidës apo parathënies, për t'ia lëshuar vendin reprezantimit të Dibrës me sytë e të huajve.

Nëse do të theksoja një dukuri historike për dibranët si njerëz me vetëdije të pabujë patriotike, sakrifikues jopatetikë për fatet e Shqipërisë, kjo dukuri është me siguri ai fakt i pa vënë re dhe i pa artikuluar si duhet, që varret e djelmënisë dibrane i gjen në të katër cepat e Shqipërisë në mbrojtje të tokave shqiptare, nga tokat në kufijtë me Greqinë, Kosovë, Vlorë, Lumë e Tarabosh të Shkodrës e gjer në Sanxhak të Bosnjës, por nuk mund të thuhet e anasjellta (që të ketë varre vullnetarësh nga krahina të tjera shqiptare në mbrojtje të tokës dhe jetës së di-

Posta e Rruga Arbërit

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Selman Mziu, Qeram Cibaku, Ramiz Gjini, Përparim Tomçini, Bernard Zotaj, Xhelal Roçi, Kujtim Boriçi, Rexhep Torte, Abdurahim Ashiku, Ymer Keta, Beqir Sina, etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër. Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Redaksia:
Në Dibër:
Rexhep Torte
Në Athinë:
Abdurrahim Ashiku
Në Itali:
Selman Mziu
Në New York:
Beqir Sina
Në Tiranë:
Prof. Dr. Bashkim Lleshi,
Naim Plaku

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. (04) 2233 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Në mjediset e Hotel Tirana International, më 13 qershor 2008, Shoqata **Lidhja e Intelektualëve Dibranë** mbajti sesionin shkencor "Dibra me sytë e të huajve".

Shoqata "**Lidhja e Intelektualëve Dibranë**" organizon në Tiranë sesionin shkencor

"Dibra me sytë e të huajve"

Në mjediset e Hotel Tirana International, më 13 qershor 2008, Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë mbajti sesionin shkencor "Dibra me sytë e të huajve".

Fjalën e hapjes së këtij sesioni shkencor e mbajti kryetari i shoqatës LID, Prof. Dr. Nuri Abdiu, i cili, mes të tjerash tha: "Dibra e nëntë maleve, shtatë teqeve, shumë xhamive, kishave dhe vlerave të tjera unikale të saj, ka joshur e tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve të vendeve të ndryshme të botës, që nga shekulli V p.e.s, kur historiani i Greqisë së lashtë Herodoti përmend fisin e doberëve (dmth të dibranëve) e deri te misionarët anglezë Rexhinald Hiberti, Julian Emeri, etj., që kaluan nëpër shumë vise të Dibrës gjatë Luftës së Dytë Botërore". Më pas ai bëri një përmbledhje të synimit të këtij Sesioni Shkencor, duke e vënë theksin në eksplorimin dhe studimin e Dibrës nga të huajt. "Të gjitha ata që kaluan nëpër Dibër e që ishin jo pak, por disa dhe që vinin nga Gjermania, Austria, Italia, Serbia, Hungaria, Franca, Anglia, Rusia, Bullgaria, vendet e Lindjes së Mesme, etj., nuk i solli rastësia, nuk kaluan nëpër vendin tonë dhe nuk u fokusuan në Dibër për "tebdil hava", por për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave që u ishin ngarkuar. Shumë prej tyre vëzhguan e hulumtuan me mençuri, aftësitë dhe virtyt dibrane, trimërinë, zgjuarsinë e mprehtësinë e tyre që shpalosej, veçmas odave e sofrave, kuvendeve e takimeve, në festa, dasma e morte, në ditë besëlidhjesh e falje gjaqesh. Ata i testuan dibranët dhe, në përgjithësi i vlerësuan, me dashamirësi e objektivitet."

"Shoqata LID, - tha në fund të përshëndetjes së tij Prof. Dr. Nuri Abdiu, e shtyrë nga ndjenja e përgjegjësisë dhe vetëdija profesionale, për të pasqyruar në mënyrë sa më të plotë edhe këtë tablo të kontributit të dibranëve në zhvillimet historike-kulturore mbarëshqiptare, për të nxjerrë në pah disa nga veçantitë, specifikat e historisë, kulturës dhe trashëgimisë etnokulturore të kësaj treve, organizon këtë sesion shkencor, me synimin që të krijojë edhe një lidhje e komunikim sa më të ngushtë e cilësor midis brezave të ndryshëm të dibranëve, kudo që ata jetojnë e punojnë në kushtet e globalizimit bashkëkohor".

Prof. Dr. Nuri Abdiu: "Shoqata LID e shtyrë nga ndjenja e përgjegjësisë dhe vetëdija profesionale, për të pasqyruar në mënyrë sa më të plotë edhe këtë tablo të kontributit të dibranëve në zhvillimet historike-kulturore mbarëshqiptare, për të nxjerrë në pah disa nga veçantitë, specifikat e historisë, kulturës dhe trashëgimisë etnokulturore të kësaj treve, organizon këtë sesion shkencor, me synimin që të krijojë edhe një lidhje e komunikim sa më të ngushtë e cilësor midis brezave të ndryshëm të dibranëve, kudo që ata jetojnë e punojnë në kushtet e globalizimit bashkëkohor".



Në foto: Pjesëmarrësit në sallë gjatë simpoziumit shkencor "Dibra me sytë e të huajve"

Më pas, Agron Tufa prezantoi librin "Dibra me sytë e të huajve", i botuar nga shtëpia botuese "m&b". Pasi bëri një pasqyrë të shkurtër të librit, Agron Tufa referoi mbi temën: "Alegoria, paravolitë alegorike dibrane".

Mbi "Vlerat e etnokulturës në Dibër" referoi Prof. Mark Tirta; Dr. Laurant Bica referoi mbi "Fisnikërinë dibrane"; Prof. As. Dr. Adem Bunguri referoi mbi temën "Dibra si njësi e lashtë në konfiguracionin e fiseve ilire. Periudha të ndryshme nga antikiteti i hershëm - tek periudha postantike"; Prof. Dr. Vaso Tole mbi temën "Variacione muzikore dhe formacione folklorike nga trevat e ndryshme të Dibrës. Lloje dhe zhanre të vjetra muzikore. Dukuri të krijimtarisë së rapsodit popullor Hazis Ndreut"; Prof. Dr. Ferid Duka me temën "Kastriotët dhe principata e tyre. Të tjerë princër dibranë - Moisi Golemi, etj. Timaret"; Dr. Shefqet Hoxha me temën "Dibra dhe dibranët në luftërat kundër okupacionit serb" dhe Prof. Dr. Hasan Çipuri: "Arti ushtarak shqiptar në epokën e Skënderbeut."

"E veçanta e këtij sesioni, tha për gazetën Kryetari i Shoqatës LID, Prof. Nuri Abdiu, është përpjekja e bërë, që rikrijimin e imazhit të Dibrës dhe të dibranëve, mendësive dhe kulturës së saj ta bëjmë në mënyrë sa më të paanshme, duke lënë që ta flasin dokumentet dhe studimet e jodibranëve dhe të të huajve. Gjithashtu, shtoi ai, kjo veprimtari serioze, ky sesion shkencor, nuk mund të realizohej pa ndihmën e madhe të biznesmenëve dibranë që kanë sponsorizuar përgatitjen dhe mbajtjen e tij. Nuk mund të realizohej dhe pa ndihmën e specialistëve që përgatitën kumtesat, historianëve, antropologëve, etnologëve, filozofëve, muzikologëve, gjuhëtarëve të njohur e të tjerë".

Një kronikë mbi historinë, arkeologjinë, etnografinë, natyrën dhe Odën dibrane, e përgatitur nga gazetari i vjetër i Televizionit Shqiptar Sami Selishta shoqëroi këtë aktivitet, duke i dhënë një pamje më të plotë historisë së Dibrës.

Musa Ricku, njëri nga biznesmenët dhe intelektualët dibranë, që mbështeti fuqishëm këtë veprimtari dhe sponsorizoi botimin e librit "Dibra me sytë e të huajve", tha për gazetën se kjo ishte vetëm një përpjekje për evidentimin e vlerave dibranë në metropolin shqiptar. Shoqata LID dhe biznesmenët dibranë do të organizojnë veprimtari e botime të tjera me më shumë vlerë, për ta vendosur Dibrën në vendin që i takon në historinë e Shqipërisë".

Korresp. "Rruga e Arbërit"

SPONSORË TË SESIONIT SHKENCOR:

"Risku" sh.p.k. - Musa Riçku
"Aurora Group" - Rakip Suli
"Usluga CO" - Sadri Abazi
"M&B - Botime & Studio Grafike" - Bujar Karoshi
"Pro Gips" - Uzri Hoxha
"Almo Konstruksion" - Shaban Bitri
Shkolla "Sarina 2002" - Liman Hoxha
"Pellumbat e Paqes" - Fatmir Kurti
"Infinit Plus" - Shehat Kurti
"Itali Pamelli" - Demir Rusi
"Qendra Franklin" - Shpëtim Cami
"Agro Herbel" sh.p.k. - Arif Doçi
"Andi Konstruksion" - Latif Muha
"Market Rruga e Arbërit" - Musa Kurti



branëve), qoftë edhe në përballimin e luftës më të trishtuar të dibranëve me armikun shekullor e më mizor për etninë tonë – serbët – të pakrahasueshëm për nga shkalla e egërsisë dhe masakrave. Këtë të vërtetë historiografia shqiptare ia ka borxh Dibrës. Dhe po për hir të kësaj të vërtete duhet të kemi kurajën ta themi hapur se historiografia komuniste, e cila nuk la kryengritje fshatare, të rëndësishme a të papërfillshme pa përmendur në qindra faqe e volume, - për Dibrën u tregua koprace e hipokrite, jo vetëm duke mos i dhënë minimumin e domosdoshëm, por duke heshtur qëllimshëm, në indiferencë të qëllimshme, duke i përjashtuar, si historinë, si folklorin e këtyre luftërave – qëllimshëm.

I rikthehemi konceptit "Dibra me sytë e të huajve". Ky rekonstruktim apo *përkapje* e imazhit të Dibrës dhe dibranëve realizohet në këtë libër në dy nivele. Të kuptohemi drejtë: me togfjalëshin "të huaj", këtu cilësojmë jo shqiptarët e trevave të tjera, të cilët janë bashkatdhetarët dhe se përcaktori "i huaj" për ta, nuk ka funksion pezhorativ. Më saktë, kuptimi i librit "Dibra me sytë e të huajve" që merr në dorë lexuesi, anon tek kuptimi "Dibra me sytë e jodibranëve". Titulli i librit u zgjodh në të mirë të një gjesti: për t'u distancuar nga ajo traditë kolerike që është përhapur gjerësisht pas rënies së komunizmit me botime të shumta e kaotike, pa farë vlere, kryesisht lëvdata e hosana për çdo derë, krahinë, fshat, oxhak, bajrak apo derë të madhe. Na u duk më interesante të përftonim një imazh të Dibrës duke mos folë vetë për të, por duke lënë të tjerët të flasin, dorëzanë neutralë, kryesisht udhëtarë të huaj, studiues, albanologë, historianë e antropologë, të cilët nuk kanë arsye, së paku subjektive, të lëvdojnë, nisur nga sensibilitete të patriotizmës krahinore. Madje qëllimi është pikërisht ky: që imazhi i Dibrës të jepet së jashtmi, e para në nivelin e jo dibranëve, e dyta – në nivelin e të huajve.

Por arsyeja më e madhe pse jemi mjaftuar me kaq në etydin tonë, gjithësesi subjektiv, është ekzistenca e dy volumeve të mrekullueshme "Dibra dhe etnokultura e saj", të botuar në vitin 1995 nga Lidhja e Historianëve shqiptarë dibranë, volume të cilat shterrojnë nga shumë pikëpamje një tërësi të larmishme problemesh e aspektesh historiko-kulturore të trevës së Dibrës. Kontributi i këtyre dy volumeve solide është jashtëzakonisht i madh, shkencor, e mjerisht, i pavënë re dhe i pavlerësuar sa e meritojnë, si për historianët dhe etnologët dibranë, si për emrat e respektuar të shkencave tona historiografike.

Në këtë libër kemi përzgjedhur një pjesë të teksteve që flasin për periudha të ndryshme historike, veçanërisht për mesjetën, Kastriotët dhe "motin e madh" të Skënderbeut, nëpërmjet të cilave na shpërfaqet Dibra dhe dibranët me historinë e tyre. Meqenëse një përfshirje e plotë e të gjitha teksteve nuk është e mundur në këtë botim modest, libri mbetet i hapur për t'u pasuruar më vonë me gjetjet, gjurmimet dhe zbulimet e reja dhe se atë mund ta vazhdojë çdo pasionant i këtij koncepsioni. Dhe natyrisht një gjë e tillë është e mundur, duke i ditur më së miri kufizimet tona. Libri do të mundohet të realizojë paralelisht parimin kronologjik dhe, me sa është e mundur, atë tematik.

Agron Tufa
Tiranë, 1 qershor 2008
(Marrë nga libri)

Një vështrim mbi qytetin e Dibrës së Madhe: Gjendja ekonomike katastrofike, mungese e frondeve për punë, kufiri pa regjim të lirë vizash, punësimet partiake, sytë drejt mërgimit, Rruga e Arbërit...

Shkatërrimtarët e Dibrës së Madhe





Nga Rexhep TORTE

- Dibra e Madhe sot i ngjan një xhehenemi ekonomik e social dhe një qyteti në shkatërrim e sipër, i cili sfidon vetëm falë këmbëngulësisë dhe guximit viktimizues patriotik të qytetarëve të saj të ndershëm e fisnikë

HISTORIA E DHEMBSHME

Dibra e Madhe në lulëzimin e vet në shekullin e 19 dhe fillimshekullin e 20 ishte qendër shumë e zhvilluar dhe e rëndësishme zejtare,tregtare dhe kulturore. Ky qytet përbënte nyjën kryesore të tregut unik shqiptar qoftë nga Durrësi për në Sofje,qoftë nga Selaniku për në Manastir e Kosovë.

Teposhtëza e Dibrës së Madhe filloi me vrasjet, djegiet, grabitjet dhe shkatërrimet fatale tri herë radhazi nga hordhitë serbe dhe me vendosjen padrejtësisht të kufirit me insistimin hegjemonist ruso-serb dhe mbështetjen e Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitet 1912/13,dhe konfirmimin në Konferencën e Paqes në Paris në vitet 1919/20, kur Dibra e Madhe u nda nga trungu stërgjyshëror dhe mbeti në Maqedoni.

GJENDJA EKONOMIKE KATASTROFIKE

Me ekonomi tejet të alivanosur, me mungesë stimulimi për zhvillimin e ekonomisë së vogël e të mesme, me bujqësi në dekadencë, me paralizim total të sistemit të ujitjes, me regjim ndërkufitar vizash pengues e jo zhvillues, me më shumë se katër mijë persona që kërkojnë të punësohen në Byronë për punësim, me një mijë e pesëqind përfitues të ndihmës sociale, me një numër të madh personash që trokasin në derën e pushtetit vendor për ndihma njëherëshe për bukën e gojës, qytet pa asfarë kushtesh ku rinia do ta kalonte kohën e lirë në mënyrë të dobishme e të kulturuar dhe jashtë kthetrave devijante e të drogës, me tendencë mërgimi të qytetarëve në rritje të vazhdueshme, Dibra e madhe sot i ngjan një xhehenemi ekonomik dhe social, një qyteti në shkatërrim e sipër, i cili sfidon vetëm falë këmbëngulësisë dhe guximit viktimizues patriotik të qytetarëve të saj të ndershëm e fisnikë.

MUNGESA E FRONTEVE PËR PUNË

Nga orët e mëngjesit qendra e qytetit është pothuajse e vdekur dhe mund të takosh tek -tuk ndonjë person. Kjo sepse në Dibër të Madhe mungojnë fabrikat dhe frontet e punës, që do ta gumëzhinin qytetin në orët e mëngjezit duke vajtur në punë dhe në orët e pasditës duke u kthyer nga puna.

Bujqit e vyer dibranë edhe pse me dëshirë të zjarrtë për punë, nuk kanë mundësi stimuluese dhe pikë uji nga Sistemi dhe rrjeti i ujitjes.Veç drithërave të mbjella në mungesë të ujit kanë nguruar të mbjellin ngastrat me misër,fasule e zarzavate tjera, edhe pse çmimet e artikujve ushqimorë çdo ditë shkojnë në rritje. Qeveritë miskine maqedonase si dje edhe sot nëpërmjet pezullimit të fondeve dhe mosaprovimit të projekteve zhvillimore, më shumë se gjysëm shekulli Dibrën e Madhe shohin me sy shkatërrues, xheloz e përbuzës. Se çfarë qëndrimi shkatërrues ndaj Dibrës së madhe kanë patur qeveritë maqedonase,tregojnë qartë segmentet rrugore prej 25 kilometrave nga Dibra e Madhe drejtim të Shkupit dhe të Strugës me gjërësi vetëm 5 metra.

KUFIRI PA REGJIM TË LIRË VIZASH

Edhe pas gjysëmshekulli të perdes së hekurt të kufirit, edhe pas tetëmbëdhjetë viteve të demokracisë, mosangazhimi sa duhet i Shkupit dhe Tiranës në drejtim të liberalizimit të vizave, kanë bërë që në vendallimin kufitar të Bllatës edhe pse i pajisur me personelin kufitar të shërbimit, çdo ditë të kalojnë vetëm dhjetëra vizitorë dhe disa automjete, mes tyre vetëm ndonjëri i ngarkuar me tulla ose tjegulla, sepse mallrat e tjera janë orientuar për çdoganim në vendkalimin Qafë Thanë te Struga.

PUNËSIMET PARTIAKE

Nga papunësia e madhe dhe interesimi për të gjetur punë, bijnë në sy punësimet partiake sidomos gjatë fushatës parazgjedhore dhe pasgjedhore, në pjesën më të madhe duke punësuar persona që sjellin vota, e duke përjashtuar cilësinë dhe vlerat profesionale. Faktor ky që dashtë pa dashtë bën që dibranët të jenë pre e manipulimeve dhe e denigrimeve partiake, shpeshherë duke kaluar nga një parti në tjetrën varësisht nga premtimet e dhëna.

SYTË DREJT MËRGIMIT

Në Agjensionin për punësim në Dibër të Madhe presin punë më shumë se katër mijë persona, mes tyre edhe me arsim sipëror. Në mungesë të vendeve adekuate të punës disa të rinj të diplomuar punojnë si shoferë taksish apo kamarierë, ndërsa pjesa më e madhe ka mbetur e zhgënjyer dhe e dëshpëruar.

Nga varfëria dhe pamundësia për të gjetur punë shumë qytetarë trokasin në derën e kryetarit të komunës qoftë edhe për ndihmë të njëhershme sa për të siguruar bukën e gojës për disa ditë.

Kabinetet shkollore në dy shkollat fillore dhe në atë të mesme janë të pa pajisur fare, aty mësimi zhvillohet në mënyrë tejet primitive. Bibliotekat e shkollave gjithashtu janë pa libra të mjaftueshme.

Askush deritani nuk ka krijuar kushte që të rinjtë dibranë kohën e lirë ta kalojnë në mënyrë të dobishme e të kulturuar. Të rinjtë dibranë janë lënë në mëshirën e rrugëve, të kafeneve dhe të drogës, që për fat të keq kohëve të fundit e ka kapluar edhe rininë dibrane në nivel tepër shqetësues.

Këto rrethana të padurueshme kanë ndikuar që prindërit dibranë dhe të rinjtë dibranë të mendojnë për ta braktisur Dibrën e Madhe , duke migruar jashtë vendit nëpërmjet lotarisë amerikane ose në të zezë duke paguar shuma të mëdha dollarësh.

MËRGATA DORËSHTRËNGUAR

Mërgimi i hershëm dhe numri i madh i mërgimtarëve dibranë në shumë shtete të botës, sidomos në SHBA dhe dëshmimi i tyre si biznesmenë të suksesshëm, ka bërë që të posedojnë miliona e miliona dollarë. Megjithatë përveç dibrano-amerikanit Ibrahim Kolari,asnjë dibran tjetër mërgimtar nuk ka investuar në rritjen e biznesit dhe të ekonomisë në Dibër të Madhe. Pjesa dërmuese e mërgimtarëve biznismenë dibranë është e prirur të premtojë shumë e të mos realizojë asgjë në vendlindje. Mbase këta biznesmenë kanë të drejtë kur flasin për burokracinë dhe pasigurinë e kapitalit në Maqedoni, sepse nuk duan të kenë risk në shpenzimet e parave të tyre të fituara me mund e djersë.

NJË FAKULTET EDHE NË DIBËR TË MADHE

Një nga nënshkrueset për hapjen e Universitetit të Tetovës në vitin 1994 ishte edhe pushteti vendor i Dibrës së Madhe. Megjithatë kaluan kaqë vite dhe janë hapur fakultete të këtij universiteti në Gostivar, Strugë e tash mendohet të hapen edhe në Shkup e Kumanovë, ndërkaq për hapjen e një fakulteti në Dibër të Madhe nuk mendohet fare. Ka mendime se do të ishte mirë që në Dibër të Madhe të hapet Fakulteti i Kulturës Fizike, sepse ekzistojnë mundësi dhe terrene tokësore dhe ujore për këtë degë, e para, dhe e dyta, Dibra e Madhe ka në afërsi zona të gjera të Shqipërisë prej ku mund të vinin shumë të rinj për të studjuar në këtë fakultet. Dibra e Madhe e meriton ta ketë një fakultet sepse vënia e nënshkrimit për hapjen e UT-së asokohe nuk ishte gjë e lehtë dhe se shumë qytete tona nuk patën guximin ta japin nënshkrimin e tyre.

RRUGA E ARBËRIT SJELL ZHVILLIMIN

Pozita gjeostrategjike e Dibrës së Madhe fillimi i ndërtimi të Rrugës së Arbërit në segmentin rrugor prej 17 kilometrave nga çezmat e Çerenecit deri në Bulqizë të Shqipërisë, kanë rritur shpresën për një frymëmarrje zhvillimore të Zonës së Dibrës. Ndërtimi i kësaj rruge distancën nga Dibra deri në Tiranë do ta bënte 72 kilometra. Kalimi i kësaj rruge nga Shqipëria për në Maqedoni nëpër Dibër të Madhe do të mundësojë zhvillimin e hovshëm të Dibrës dhe të zonës më gjerë. Pritet që Shqipëria dhe Maqedonia sa më shpejt ta ndërtojnë pjesën e vet të kësaj rruge në të mirë të Dibrës dhe të tërë qyteteve ku kalon kjo rrugë.

Minierat e kromit, Ministri i Ekonomisë replikon me firmat e licencuara të Bulqizës:

Ju nxisni punën pa kushte sigurie

Qeveria nuk po ia del dot të vërë nën kontroll situatën e vështirë dhe të rrezikshme që është krijuar në minierën e Bulqizës, ku shumë banorë të zonave përreth, në mënyrë të paligjshme shfrytëzojnë rezervat e mineraleve duke rrezikuar jetët e tyre. Edhe pas paralajmërimeve për denoncime në prokurori dhe përfshirjen e policisë për të normalizuar situatën, duket se gjendja në miniera vazhdon të mbetet kaotike. Ministri i Ekonomisë dhe Energjetikës, Genc Ruli, ka akuzuar për këtë shoqëritë e ligjshme, që kanë licenca për të shfrytëzuar minierat apo stoqet e mineraleve, pasi, sipas tij, janë ato që i nxisin banorët për të mbledhur krom në stoqet e akumuluara në vite.

Ruli u është drejtuar përfaqësuesve të shoqërive minerare me tone të ashpra duke i kërcënuar ata me ndëshkime të ashpra nëse kjo situatë do të vazhdojë. "Ne kemi informacion të plotë dhe të saktë se kjo dukuri po nxitet nga ju. Kemi kontrolluar shifrat e eksportit dhe rezervat tuaja minerare në Portin e Durrësit dhe i kemi krahasuar ato me kapacitetet e minierave që keni në përdorim. Nuk rakordojnë, çka tregon se kromin e mbledhur nga banorët e blini ju", tha Ruli. Më tej, kreu i Energjetikës ka paralajmëruar masa ndëshkuese. "Qeveria nuk ka ndër mend të tolerojë këtë situatë. Ju paralajmëroj nëse sërish do të kemi informacione se ju po vazhdoni të nxisni banorët të mbledhin stoqet e mineraleve do të heqim licencat", kërcënoi Ruli.



Fjala dhe kuvendi i dibranit shquhet për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por edhe për këmbëngulje e qëndresë imponuese, bindëse.

Fisnikëria dibrane

Nga: **Dr. LAURANT BICA**

(Vijon nga faqja 1)



1. FISNIKËRIA SI SHTRESË SHOQËRORE

(Roli i fisnikërisë dibrane në historinë kombëtare dhe më gjerë)

Natyrisht, ekzistenca e fisnikërisë nuk është një fenomen thjesht shqiptar në mesjetë, por mbarëeuropian e më gjerë botëror. Fisnikëria apo klasa drejtuese, kjo shtresë e shoqërisë shqiptare të mesjetës, përfshi dhe atë të një religjioni të caktuar, Dibrës, nuk binte më poshtë se ajo evropiane ose më mirë të themi nuk dallohej aspak nga ajo, ishte në të njëjtat parametra, bile, duke marrë parasysh që ishte pjesë e aristokracisë së Perandorisë Bizantine, e cila arriti majat e një qytetërimi të shkëlqyer në kulmet e saj; në shumë drejtime ia kalonte asaj europianoperëndimore.

Kjo situatë vazhdoi edhe në shekujt osmanë. Ndërroi vetëm feja. Fisnikëria dibrane nuk i ka lënë asgjë mangut asaj evropiane, në sjelljen e saj mondane, në mikpritje, në veshje, në maniera, në pushimet e saj, në luksin e saj, etj, etj. Familjet princërore shqiptare të mesjetës ishin lidhur direkt me oborrin bizantin dhe oborret më të shquar mbretërore të Europës perëndimore e qendrore, si me lidhjet martesore, dinastike, jepnin e merrnin vajza me Francën, Spanjën, Italinë, Gjermaninë, Austrinë, Hungarinë, pa folur në Bizant. Një pjesë e tyre si Arianitët etj., kishin lidhje direkte me oborrin perandorak bizantin.

Rrënja e atij regjioni të sotëm që quhet Maqedoni, e që dje është quajtur Vilajet i Manastirit, plus minus këto apo ato territore sipas ndryshimeve administrative të kohëve të ndryshme, është ajo që është quajtur Dibër e Madhe dhe Dibër e Vogël (pra dy Dibrat), dhe rrënja e Dibrave është fisnikëria dibrane apo ajo që do ta quaja dinastia, familja e madhe fisnike Gropaj, sipas emrit të fshatit nga rridhte apo Çoku (Qoku) sipas mbiemrit të origjinës.

Familja princërore e Gropajve (apo Çokëve, e njëjta gjë) del që në vitin e largët 1218 (tetë shekuj përpara) në histori. Këtë e kemi nga një dokument i zbuluar nga Akademia e Shkencave të Berlinit, që flet për të dhe një nga prekursorët e saj sevasti Andrea Gropa (Titulll i një ofiqari bizantin që vjen menjëherë pas perandorit). Rreth gjashtë dekada më vonë del prapë një Pal Gropa në vitet 1272-1273 në tratativa me Anzhuinët, i cili flet jo vetëm në emër të vet, por në krye të një grupi bujarësh shqiptarë.

Një Andrea Gropa tjetër më pas do të jetë dhëndër i Andrea Muzakës, i dinastisë tjetër princërore fqinje me ta dhe së bashku do të mundnin Marko Kralin, njri i mbretit serb Stefan Dushanit dhe prindi Muzakaj do t'u bashkojë zotërimeve të veta Kosturin, ndërsa princi Gropaj do t'u bashkojë feudeve të veta qytetin e Ohrit. Kjo në mesin e shekullit XIV. Stefan Dushani do ta linte kokën e vet duke kaluar lumin Devoll, zotërim i Muzakajve. Gropajt dhe Muzakajt, dy familje të fuqishme feudale të Shqipërisë lindore do të hynin në histori si armiq të betuar tradicionale të serbëve, si antiserbë të deklaruar.

Më 1389, në krah të Teodor Korona Muzakës, do të luftonte dhe një fisnik Gropa në betejën e famshme të Kosovës, të koalicionit ballkanik kundër invadorëve osmanë. Kështu do t'i shohim krah për krah Muzakajt e Gropajt në histori të pandarë nga njëri-tjetri. Zaharia Gropa do të ishte, si të thuash, në periudhën skënderbegiane, mesin e shekullit XV, ministër i jashtëm i kryetrimit Skënderbe, do të shkonte në misione të caktuara në Itali, Romë, Venedik, Raguzë dhe do të dallohej jo vetëm si diplomat, por do të ishte një ndër dy gjeneralët më të shquar të tij në betejat për 25 vjet rresht me osmanlinjtë.

Gropajt kanë qenë suzerenë të Patriarkanës së Ohrit, për sa kohë ekzistoi ajo deri në vitin 1767, kur ajo u mbyll nga Patriarkana e Madhe e Kostandinopojës. Patriarkana e Ohrit ka qenë nën mbrojtjen dhe kontrollin e tyre dhe në shumicën e saj patrikët e saj kanë qenë të gjakut shqiptar.

Pas vdekjes së Skënderbeut, me Gropajt u përsërit ajo që u ndodhi gjithë princërve shqiptarë. Një pjesë e mirë kaluan detin dhe u vendosën në Italinë e Jugut. Gjurmë të fisnikëve Gropaj gjejmë në një fshat arbëresh midis Brindisit e Barit, në Monteçilione, ku çdo vit bëhet festivali e parada me veshjet e fisnikërisë shqiptare, si të Vrana Kontit, Muzakajve, Gropajve e të tjerë. I gjithë fshati dhe ndonjë fshat arbëresh përreth e mban veten se ka prejardhje fisnikë. Një pjesë u islamizuan dhe ruajtën pronat, u bënë pashallarë në Ohër, Dibër, Strugë etj. Në fillim përdorën fenomenin e laramanisë, si kriptokristinë, dhe më pas u islamizuan plotësisht, por si besimtarë të sektit bektashi. Nuk është e rastit përhapja e bektashizmit në këë shkallë në zonën e Dibrës.

Një krah i Gropajve apo Çokëve vazhdoi në kryeqytetin e Perandorisë Osmane, aty ku vendosej fati i çdo gjëje, dhe i pronave të tyre, apo dhe i tërë Perandorisë. Nuk është e rastit që në shekullin XVI në Perëndim gjejmë një Papë i mbiquajtur Papa Çoka (apo Çoku), dhe po në këtë shekull, në apogjeun e supershtetit osman, gjejmë një kryeministër me origjinë nga bejlerët e pashallarët e Ohrit, Halil Pashë Ohri. KJo familje princërore i mbijetoi kohërave si në Lindje, ashtu dhe në Perëndim. Në vitet '40, '50, '60, të shekullit XIX Iljaz Pashë Dibra (Çoku-Gropaj) përmendet si hero kombëtar i shqiptarëve. Dibrës i ra për risk të luftojë kundër të gjithë fqinjëve grabitqarë, edhe bullgarë në lindje, edhe në verilindje në Toplicë, Nish, kundër serbëve, edhe në Thesali e Selanik kundër grekëve, por edhe kundër malazezëve.

Një nga ato që është në linjë direkte, në vijimësi, është fisi në fillim me mbiemrin Beqiri, e pastaj i shndërruar në Hajdaraga, nga familjet e parësisë së Dibrës. Po nga Çokët rrjedhin dhe këto katër oxhaqe të Dibrës: Në Dibër të Madhe ishte shtëpia e Hoxhollit; në Dibër të Poshtme ishin tre oxhaqe: ai i Agollëve në Dohoshisht, ai i Karahasanit në Brezhdan dhe ai i Xhilagës në Deshat. Në Shpalljen e Pavarësisë më 1912 Ohrin e Strugën i përfaqësuan Gropajt, Zyhdi Ohri (Çoku) dhe Xhemal Ohri (Çoku), bejlerë të Ohrit, fis i Hamdi Ohrit, si dhe Mustafa Barotçia. Në Krah të Ismail Qemalit qenë dy fisnikë dibranë. Dy nënkryetarët e Kuvednit Kombëtar të Vlorës ishin Vehbi Agolli (Dibra) dhe Dom Nikollë Kaçori, njëri hoxhë e tjetri prift, por të dy atdhetarë të kulluar. i pari nga oxhaku i Agollëve, rrjedhimisht, siç e kemi thënë më sipër, prapë ishin me rrënjë Çoku (Gropaj). Ai u zgjodh kryetar i Pleqësisë (Senatit) në Kuvendin e Vlorës. Pra, në Pavarësi ishin oxhakët e Shqipërisë që përfaqësonin popullin shqiptar. Ismail Qemali (Vlorajt), Murat Toptani (Toptanët, Topiajt), Zyhdi e Xhemal Ohri (Çoku), Vehbi Agolli (Çoku), Mithat Frashëri (Frashërllinjtë, Dukollarët, etj., etj. Kongresi i Triestes më 1913, ku mori pjesë dhe një Faik Konicë etj, figura eminente atdhetare, ishte vepër veç të tjerëve e atdhetarit Hamdi Ohri.

Në të njëjtën rrugë eci dhe i fundmi fisnik i Gropajve. Në gjurmë të derës së vet fisnikë ishte Mentor Çoku, djali i Hamdi Ohrit, që në Asamblenë Kombëtare të 1943 ku ishte deputet i Strugës, deklaroi burrërisht se Shqipëria nuk e pranon pushtimin fashist. Ishte ideali kombëtar që në vitin 1944, në kohën e gjermanëve, kur këta u prishën me bullgarët dhe vendlindja e tij Ohri mbeti pa zot për pesë ditë rresht, e shtyu të fusë 10 vetë të armatosur të veshur me kostum kombëtar e qeleshe të bardha, të ngrenë flamurin shqiptar kuq e zi me shkabën dykrenore, për të treguar se Ohri është shqiptar, është Shqipëri. Për këtë ideal fisnik gjatë luftës ai mori dy plafë në trupin e tij. Ishte po ky ideal që më 1991, sikurse i ati tetë dekada më parë më 1913, të bëjë në Trieste me iniciativën e vet takimin Berisha-Nano, për të biseduar e gjetur "gjuhën" midis tyre në emër të së ardhmes së Shqipërisë...

> Fisnikëria dibrane nuk i ka lënë asgjë mangut asaj evropiane, në sjelljen e saj mondane, në mikpritje, në veshje, në maniera, në pushimet e saj, në luksin e saj..

2. FISNIKËRIA SI VIRTYT

Unë fisnikërinë si virtyt moral do ta shihja në disa plane, e do ta zbërtheja si më poshtë:

Së pari, si një sjellje e caktuar, që do ta përfshija në fjalën "zotnillëk" apo "xhentëlmen".

Së dyti, fisnikërinë unë do ta kuptoja në zakonin e mikpritjes.

Së treti, me fisnikëri unë do të kuptoja njerëzit mirëbërës, bujarë.

Së katërti, si një ndikim, si një autoritet moral, shpirtëror.

Së pesti, si burrni.

Së gjashti, një ballafaqim me vështirësitë e jetës, si guxim, si trimëri.

Së shtati, në kuptimin e virtytit, edhe si pastërti morale.

Së teti, mbajtjen e fjalës së dhënë, besën. Dibrani e ka të rëndë dhënien e fjalës, por kur e jep nuk e tradhton besën.

Së nënti, dhe së fundi, do të kuptoja zgjuarsinë, inteligjencën, mençurinë dhe ky është një element thelbësor i saj.


Unë do të ndalem vetëm në një aspekt të saj, në atë si "mençuri".

Është e famshme mençuria dibrane, po dhe ajo që quhet "alegoria dibrane". Unë po u përmend dy profesorë të saj, filozofin Dine Hoxha, dhe i dyti Haziz Ndreu, edhe këngëtar e folklorist i mirënjohur. Të parin e kanë quajtur Dekan i "Universitetit të Dibrës", "Sokrati i Dibrës", "Profesor i alegorisë dibrane", dhe atë e njihte mbarë Shqipëria. Vetë mbreti Zog e kishte këshilltarin e ve. Ai ishte nga Muhuri i Dibrës. Sipas popullit të këtyre anëve, "Djepi i urtësisë së Nëntë maleve të Dibrës është në fshatin Muhur". Profesori i dytë është Haziz Ndreu, i cili ka shkruar një vepër të tërë, të mirënjohur, me emrin "Alegoria dibrane".

Dihet se tek ilirët, në dallim nga tërë popujt e botës, kemi pasur një perëndi të veçantë që s'e ka pasur askush, një perëndi për dijen, diturinë, që s'e hasim në asnjë popull tjetër. Emri i saj është URIDIA (domethënë "Uri për dijen"). Sipas etnologut të njohur Mark Tirta, është mjaft domethënëse formula e mirënjohur e proverbiale që thotë se "Mendja", "Urtia" ka le në Dibër...

Fjala dhe kuvendi i dibranit shquhet për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por edhe për këmbëngulje e qëndresë imponuese, bindëse.

KUSH ËSHTË DR. DR. LAURANT BICA



Dr. Laurant Bica ka lindur më 18 mars 1951 në Korçë. Ka mbaruar aty gjimnazin "Themistokli Gërmenji", dhe më pas Degën e Filozofisë në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Në vitet 1973-1993 punoi si pedagog aty dhe mbrojti disertacionin për gradë shkencore "Hasan Tahsini – Jeta, vepra, idetë". Nga viti 1994 deri më 2005 jetoi në Republikën e Turqisë ku punoi si pedagog në profesion të lirë. Dy vitet e fundit punon si pedagog i jashtëm pranë universiteteve "Kristal" dhe "Marin Barleti" në Tiranë. Zotëron disa gjuhë të huaja. Ka një veprimtari të gjerë botuese si në Shqipëri, Kosovë, ashtu edhe në Turqi.

Në shek. XV Çidhna e Poshtme, së bashku me Çidhnën e Epërme , Sinë e Epër dhe e Poshtme, Gurë, Arras, Shashar, në përbërje të Kidhnës së famshme mesjetare, luajti një rol të rëndësishëm në epopenë skënderbejane kundër superfuqisë otomane.

Harta arkeologjike e zonës së **Çidhnës**



Nga Prof.asoc.dr. **ADEM BUNGURI**

(Vijon nga numri i kaluar)

4. PERIUDHA HELENISTIKE (SHEK . IV - I P.E.S)

Gjetjet e kësaj periudhe janë të pakta dhe vijnë nga dy pika të Çidhnës së Poshtme, përkatësisht nga "Vneshta e Kolës " dhe " Kepi i qytetit ".

1. Me emrin "Vneshta e Kolës "(ose "Linajshte"), njihet një tarracë thuajse eliptike me sipërfaqe te sheshtë rreth 10 ha. Ajo ndodhet në pjesën veriore të Çidhnës së Poshtme, midis rrugës automobilistike dhe lagjes "Cani " në jug dhe shkollës 9 vjecare te fshatit në veri. Tarraca ka lartësi absolute 620 m dhe relative 10 – 15 m, si dhe një pozitë domunuese mbi fushën përeth, mbi të cilën zbret me një pjerësi të theksuar, veç anës perëndimore, ku kjo pjerësi zbutet mjaft. Në shpatet lindore të kësaj tarrace, hapja e një kanali nxori në dritë disa fragmente enësh të periudhës qytetare ilire. Enët janë të punuara me çark, kanë fakurë të hollë, baltë shumë të pastër, me ngjyrë të verdhë në rozë, pjekje të plotë, me gjurmë verniku kafe në të zezë në faqen e jashtme. Ato u takojnë një kupe gjysëmefrike dhe fundit të një kantari, dhe përfaqësojnë importe të Apollonisë. Vlen të përmendet gjithashtu edhe enë bronzi të tipit hidrie, me trup gjysëmsferik, qafë të shkurtër, grykë cilindrike, dhe një vegjë tip fluture, e zbukuruar me teknikën e ngulitjes me motive gjeometrike, që i takon importit grek të shek. III-II pes [14].

2. Fortesa e njohur me emrin "Kepi i qytetit", ka një pozitcion mjaft strategjik buzë lumit Seta, krejt të ngjashëm në pikpamje topografike me atë të qytetit antik të Beratit (Antipatrea), të vendosur pranë Osumit. Sipërfaqja e brendshme e saj është tërësisht shkëmbore, dhe aq sa është e admirueshme si fortesë, aq është e pamundur si qendër e përhershme banimi. Vendbanimi i kësaj periudhe duhet të ketë qenë shtrirë si në shpatet dhe në tarracat e ngushta që shtrihen në juglindje të fortesës së "Kepit të qytetit" deri tek lumi i Setës, ku janë gjetur fragmente të vogla enësh të periudhës qytetare ilire ashtu edhe në anën veriore të saj, ku hapet një tarracë e gjërë, e mbrojtur nga erërat dhe mjaft e përshtatshme për banim, e njohur me emrin " Shashari i Ruse ", por deri më sot pa gjetje të lidhura me periudhën në shqyrtim.

Deri vonë, kjo fortesë ruante trakte të fortifikimit te saj antik[15]. Ato kanë qenë vendosur në faqen juglindore të fortesës, buzë lumit të Setës, që ishte dhe pjesa më e ekspozuar ndaj sulmeve. Murret e kësaj periudhe ishin ndërtuar me blloqe të mëdhenj gurësh të lidhur në të thatë. Ato së bashku me toponimin „Kepi i qytetit „ , si dhe ato pak gjetje qeramike, dëshmojnë ekzistencën aty të një vendbanimi të fortifikuar të periudhës ilire si dhe karakterin mbrojtës të kësaj fortese në funksion të Çidhnës së Poshtme. Të bazuar në të dhënat e praqitura më lart, mendojmë se mundësitë më të mëdha për një vendbanim të periudhës helenistike, i ofron tarraca e quajtur "Vneshta e Kolës" ("Linajshte").

Mendimet e shprehura për lokalizimin e qytetit ilir Oaenea në Çidhnën e Poshtme16, deri tani pa mbështetjen e mjaftueshme arkeologjike, bazohen kryesisht në përshkrimin e Livit, sipas te cilit, Oaenea ishte qyteti më i fortifikuar penest, i mbrojtur nga njera anë prej lumit Artatus dhe nga ana tjetër, prej nje mali shumë të lartë që mezi kalohej[17]. Përveç pozicionit strategjik të Çidhnës së Poshtme, në rrugëkalimin e shkurtër që lidhte pellgun e Dibrës dhe të Peshkopisë (Penestinë) me pellgun e Fanit (viset piruste) dhe më tej me Lezhën dhe Shkodrën (Labeatinë), (transitus et labeatis), mendimet e mësipërme janë ndikuar edhe nga përqasja fonetike e emrit Artatus me emrin e fshatit të sotëm Arras, buzë lumit te Setës dhe "Kepit të qytetit", si dhe nga mali i mezikalueshëm i Runjës në perëndim. Megjithë tërheqjen nga kjo hiptezë, duhet theksuar se lokalizimi i qytetit Oaenea, mbetet ende i diskutueshëm midis studiuesëve, për mungesë të të dhënave më të plota arkeologjike. Për aq sa njohim deri më sot, mendojmë se në Çidhnën e Poshtme, përkatësisht në Vneshtën e Kolës, duhet të ketë patur një vendbanim të hapur ilir të periudhës helenistike, e ndoshta edhe një qytet të kësaj periudhe, por kjo është ende e pambështetur plotësisht me material arkeologjik.

5. PERIUDHA ROMAKE (SHEK. I-IV E. J)

Kjo periudhë njihet nga disa pika të Çidhnës, si Çidhna e Poshtme, Fushë Alia(Xhiret e Përnezhe), Mustafajt etj.

a. Në Çidhnën e Poshtme ajo u bë e njohur nga inventari i disa varreve të zbuluara në shpatin jugor të Kodrës së Krashit, ku janë gjetur, disa objekte metalike (një tokëz rrypi bronzi, dy thika hekuri) si dhe fragmente enësh të shek. III - IV ej. si kotruve, ojnohe dhe kana.

b. Fushë-Alie(Xhiret e Përnezhe)

Nga vendbanimi i hapur romak i njoftuar nga H. Sadiku në vitet 70 të shekullit të kaluar, i vendosur në krahun e djathtë të Drinit të Zi, sot nuk ka mbetur asnjë shenjë. Gjurmët e ruajtura të tij, të përfaqësuara nga mure të ndërtuara me llaç gëlqeror, koloneta tullash dhe mozaikë, janë gryer pa mëshirë nga ujrat e Drinit, duke na kujtuar se duhet të jemi më të kujdesshëm për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë sonë arkeologjike.

c. Mustafaj

Në arat pranë shtëpisë së H. Shehut, të fshatit Mustafaj, punimet bujqësore kanë zbuluar një plor hekuri dhe një peshore balte të pjekur. Plori ka formën e një trekëndëshi dybrinjishëm me majë të mprehtë dhe bisht të gjatë me prerje katërkëndëshe. Ai është identik me një plor të tillë të zbuluar në vendbanimin e periudhës së vonë antike të Sreœnevos në Pelagoni[18] si dhe në vendbanimin e Çifllakut të Gjakovës, me kontekst të shek. III-IV e.j[19], analogji që na shërbejnë për datimin e plorit tonë në të njëjtën kohë. Gjetja e këtij plori në Mustafaj dëshmon përhapjen e madhe të zhvillimit të bujqësisë në periudhën e vonë perandorake në zonat fshatare të pellgut të Peshkopis, me toka të buta dhe rezatim të mirë diellor

6. PERIUDHA E VONË ANTIKE (SHEK.V-VI PAS KR)

Kalaja e Çidhnës(Kithinas?)

Në këtë periudhë është rifortifikuar kalaja e Kepit të Qytetit, në hyrje të Çidhnës së Poshtme. Rrënoja muresh të lidhura me llaç gëlqeror, sipas teknikës opus incertum, gjenden në anën veriperëndimore të kësaj fortese, ndërsa pranë saj, edhe gjurmë banesash, që mund t'i përkasin të njëjtës periudhë. Për rëndësinë e saj në sistemin mbrojtës të perandorisë së hershme bizantine, emri i saj regjistrohet nga nga Prokopi si një nga 32 kështjellat e ndërtuara nga Justiniani në Epirin e Ri me emrin Kithinas [20]. Mendojmë se jemi afër të vërtetës në se shprehemi për identifikimin e kësaj kështjelle në rrënojat e kështjellës së Kepit të Qytetit ose të Çidhnës. Për këtë identifikim bazohemi kryesisht në gjurmët e mureve opus incertum të ruajtura në perimetrin veriperëndimor të kështjellës, si dhe në parimin e barazmit fonetik Çidhëna = Kithinas.

7. PERIUDHA I E MESJETËS SË HERSHME (SHEK.VII-IX EJ)

Nga një pikë e panjohur e Çidhnës së Poshtme, në pavionin arkeologjik të MHP, ruhen dy varëse bronzi të ngjashme me një varëse të Krujës, të shek.VII - VIII pas Kr[21].

8. PERIUDHA II E MESJETËS SË HERSHME-(SHEK.IX-XI EJ)

Kjo periudhë u bë e njohur nga fragmentet e enëve të mbledhura në faqen lindore të Vneshtës së Kolës, ku mbizotërojnë ato me fakturë mesatare, të punuara me çark. Ato kanë brum argjilor, përgjithësisht të pastruar, me pak përmbajtje silici, të ngjeshur dhe të pjekur mirë. Sipërfaqja e jashtme, me lëmim mesatar, ka njyrë gri në të zezë, dhe shumë rallë okër në të verdhë. Enët e kësaj kategorie, zakonisht janë të zbukuruara. Në fragmentet e enëve të kategorisë së parë, ndeshen kryesisht vorbat e kuzhinës, shpesh të zbukuruara në reliev, në trajtën e një shiriti plastik horizontal me prerje konike dhe gropëzime gishti, dhe me rrallë me shtypje oblike në trajtë litari, i vendosur në shpatullat e vorbave. Ndeshet gjithashtu edhe zbukurimi i inçizuar i valëzuar apo linear, i përqëndruar në zonën e shpatullave, në një ose në dy rreshta. Vorba me formë të ngjashme dhe zbukurime të njëjta ndeshen thuajse në të gjitha qendrat mesjetare të vendit tonë e jashtë tij [22].

9. PERIUDHA E MESJETËS PARATURKE (SHEK. XIII – XIV E.J.)

Një aspekt i jetës së kësaj periudhe, është bërë i njohur nga nje thesar monedhash argjendi i gjetur në vendin e quajtur''Pusi''[23]. Thesari përmban 25 copë monedha veneciane, te prera nga mesi i shek.XIII deri në fillimin e shek.XIV (1253 – 1328). Në aspektin kronologjik, monedhat janë prerje të 6 dozhëve suksesivë të Venedikut, që kanë drejtuar republikën, që nga Ranieri Zeno (1253 – 1268) deri tek Giovani Soranzo (1312 – 1328). Në këtë vijimësi, nuk ka asnjë ndërprerje për një periudhë reth 60 vjeçare, gjë që është refleks i stabilitetit ekonomik dhe politik të rajonit ku është gjetur ky thesar. Zbulimi i tij, dëshmon për përfshirjen e zonës së Çidhnës së Poshtme në marëdheniet ekonomike tregëtare me republikën e fuqishme të Venedikut, si dhe për fuqizimin e parisë feudale vendase.

Gjithashtu kësaj periudhe i takojnë edhe disa parete enësh shumë të copëzuara dhe pa asnjë zbukurim të gjetura në një fushë skajore në jug-lindje të fshatit Çidhën e Poshtme, në vendin e quajtur''Kisha e Salës'', që përfaqëson rrënojat e njerës nga kishat paraosmane të fshatit.

10. PERIUDHA E SKËNDERBEUT

Kjo periudhë në plan arkeologjik është përfaqësuar nga dy kala tipike të Skënderbeut. E para quhet edhe kalaja e Skënderbeut, ose Çidhnës . Rrënojat e saj gjenden në një kreshtë shkëmbore me lartësi 1205 m, në thellësi të luginës së Setës. Ajo ka sipërfaqe të vogël dhe një pozicion shumë të mbrojtur nga natyra, në kontroll të Çidhnës së Poshtme dhe rrugëve dytësore që lidhnin Çidhnën me Lurën dhe kalanë e Stelushit. Në pjesën më të lartë të kalasë, duken gjurmët e një kulle rrethore, ndërsa në shpatet e saj jugore dhe lindore, lexohen trakte murresh mesjetarë të lidhur me llaç gëlqerorë të cilësisë së dobët, si dhe muret e një stere uji. Aty janë gjetur gjithashtu edhe fragmente enësh të periudhës mesjetare, me formë dhe dekor të ngjashëm me ato të kalasë së Stelushit, të Koxhaxhikut etj, të datuara në shek.XIV-XV[24]. Kjo kala shërbente si pikë vrojtimi dhe lajmërimi me anë sinjalesh dhe si vendstrehim në rast reziku, jo vetëm brenda mureve mbrojtëse, por edhe në grykat dhe lugjet përreth saj. Kalaja e dytë, e përdorur kryesisht si pikë vrojtimi, por edhe si pritë e parë e sulmeve, është ajo e Kepit të qytetit në hyrje të Çidhnës së Poshtme, e vendosur në një pozitë mjaft të mbrojtur e strategjike.

Në shek. XV Çidhna e Poshtme, së bashku me Çidhnën e Epërme(Grykë-Nokë) dhe fshatrat Sinë e Epër dhe e Poshtme, Gurë, Arras, Shashar, në përbërje të Kidhnës[25] së famshme mesjetare, luajti një rol të rëndësishëm në epopenë skënderbejane kundër superfuqisë otomane [26].

FUND

email : bunguria@yahoo.com

14 D. Kurti,Tumat IV, V, VI, VII te Burrelit, Iliria 1987, 1, f. 96.; B. Jubani, Tumat e dardanëve alpinë të Çinamakut ,disertacion, Tirane 1989, tab. LV, 1

15 Një trakt i tillë u fotografua nga fotografi R.Veseli në vitin 1974. Filmi ruhet në arkivin e IMK Tiranë, prej ku e kemi marrë, duke e përkujtuar me nderim autorin. Sipas informacionit të dhënë nga studiuesi A. Hoxha, i lindur në këtë fshat, në vitet 80' të shekullit të kaluar, blloqe të mëdha gurësh të murreve rrethuese të kësaj fortese, janë thyer me mina për qëllime ndërtimi!

16 H.Sadiku, Përpjekje për lokalizimin e disa kështjellave dhe qytezave ilire të penestëve, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, 1969, f. 255. ; K.Frashëri, Në gjurmë të qeteteve peneste, Studime Historike, 1975, 4, f. 145 ; I. Kaca, Kontribut për lokalizimin e disa qyteteve peneste, sipas te dhenave burimore e arkeologjike, "Dibra dhe dibranët" , Almanak, Peshkopi 1981, f. 71.

17 Livi, XLIII, 19, 7 - 8,

18 V. Popoviç, L'Albanie pendant la basse antique, " Les Illyriens et les Albanais ", Beograd 1988, f. 287, fig. 176, 10.

19 L.Përzhita-F.Peja, Qendra dhe gjetje arkeologjike të shek.I-IV, Harta arkeologjike e Kosovës, I, Prishtinë 2996, f. 157, fig. 6, 18.

20 Prok. Caes. De Aedeficis, IV, 29.

21 S. Anamali – H. Spahiu, Varreza arbërore e Krujës, Iliria IX - X, 1979 - 1980, f.171 -172, tab. X, 13, H. Spahiu,Elemente te traditës antike në kulturën e varrezave të mesjetës së hershme shqiptare, Ilira 1986, 1, f. 263, tab..I, 13.

22 D.Komata, Disa tipare të qeramikës mesjetare në Shqipëri, Ilirët dhe gjeneza e Shqiptarëve (13-14 mars 1969) f. 226; Gj.Karaiskaj, Gradishta e Symizës...f. 180 - 181, Tab. IX – X; H.Spahiu-D.Komata, Vep.cit. f. 295 - 296, Tab. IV

23 Monedhat janë blerë nga zbuluesi i tyre z. M. Laci ne konkursin e antikiteteve që muzeu organizoi në vitin 1978.

24 S. Anamali, Stelushi, qytet i Skënderbeut në Mat, Studime historike 1967, 4, f. 95-112 dhe në Studia Albanica, 1967, 2, f. 95-105; A. Bunguri, Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër), doreshkrim.

25 H.Inalçik, Krahina e Krujës dhe e Dibrës rreth vitit 1467, Konferenca II e StudimeveAlbanologjike, Tiranë 1969, f. 188.

26 Në gusht të vitit 1466 populli i saj u përball me masakren çnjerezore të sulltan Mehmetit II , i cili, pas dështimit të rrethimit të II të Krujës, gjatë tërheqjes për në Stamboll, kthehet nga Elbasani dhe masakron 8000-gra, pleq e fëmijë, të strehuar në Çidhnën e Poshtme, si hakmarje kundër Skënderbeut dhe njerëzve të trojeve e gjakut të tij. (Shih : G. Biemmi, Historia de vita et gestis Scander-Begh, Brescia 1742, f. 453, F. S. Noli, Historia e Skënderbeut, Tiranë 1962, f. 111). Kjo shpjegon edhe arsyen qe në defterin turk te vitit 1467 Çidhna e Poshtme kishte 8 shtëpi dhe Çidhna e Epërme(Grykënoka) 16 shtëpi. (Shih : A. Hoxha, Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit, Studime Historike, 1979, 3, f. 236 dhe Studime për epokën e Skënderbeut, II, Tiranë 1989, f. 572.). Për intensitetin e lartë të banimit në periudhën paraturke, dëshmon edhe ekzistenca në hapësirën e këtij fshati e rrënojave të 3 kishave katolike me përmasa të vogla.

intervistë

Intervistë me Ibrahim Kolarin, që njëherësh është edhe kryetar i Shoqatës Atdhetare Dibrane me seli në New Jork.

Ibrahim Kolari, dibrano-amerikani investues më i mirë në Dibër të Madhe

Investimi në vendlindje më lumturon

Në SHBA kanë emigruar më shumë se 10 mijë dibranë. Atje jeton dhe punon edhe një Dibër tjetër, ajo tej Atllantikut. Në mesin e këtyre dibranëve ka edhe shumë që janë dëshmuar të suksesshëm në bizneset e tyre dhe disponojnë pasuri që arrin miliona dollarë.Megjithatë këto dibrano-amerikanë për fat të keq në vendlindjen e tyre nuk po investojnë fare nga kapitali i tyre.

Ibrahim Kolari është i vetmi dibrano-amerikan deri më sot, i cili në Dibër të Madhe ka investuar afër 1 milionë euro duke e ngritur bazën e tij të betonit.

Ibrahim Kolari, që njëherësh është edhe kryetar i Shoqatës Atdhetare Dibrane me seli në Njy Jork, ditë më parë erdhi në vendlindje dhe për lexuesit tanë zhvilluam këtë bisedë.

LIGJI DUHET TË RESPEKTOHET E ZBATOHET

I pyetur se çka më së shumti e shqetëson në vendlindjen e tij, Ibrahim Kolari, përgjigjet se: "Më brengos së tepërmi fakti kur shikoj e dëgjoj për punën e institucioneve administrative në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë, të cilat deritani më shumë kanë punuar për për interesa vetjake se sa për vendin dhe popullin. Një gjë e tillë na turpëron të gjithëve.

Kur flasim për Maqedoninë gjendja është e ngjajshme.Rymat dhe partitë e ndryshme nuk kanë politikë të përbashkët korrektuese ndaj qeverisë, ata ngatërrohen e polemizojnë me njëri-tjetrin dhe krijojnë terren për keqpërdorime. Në Maqedoni dhe në vendet e Ballkanit, duhet ndjekur shembulli i SHBA-ve, ku janë të pranishme shumë parti e kombe të llojlojshme, por të gjithë e respektojnë dhe i përmbahen ligjit.

Duke shprehur indinjatën e tij për incidentet parazgjedhore dhe zgjedhore mes partive shqiptare në Maqedoni, ai shtoi se: "U bëj apel politikanëve që tu shmangen grindjeve. Është momenti të bashkohemi e të punojmë si punohet në vendet e demokratizuara e të zhvilluara.Para ligjit të gjithë duhet të jemi një lloj. Nuk mund të hecet para përderisa nuk respektohet e zbatohet ligji. Me këto sjellje të pamatura të partive shqiptare vetëm se e turpërojmë dhe dëmtojmë tërë popullin shqiptar dhe i bëjmë dëm vetvetes".

NGJARJET E PAKËNDSHME LARGOJNË INVESTUESIT

I pyetur se prej ku informohet mërgata jonë për ngjarjet në vendlindje, ai shprehet se:"Ne në SHBA i ndjekim të gjitha kanalet televizive prestigjioze në gjuhën shqipe, i ndjekim me vëmëndje të gjitha ngjarjet në vendlindje. Kur i shohim këto grindje politike brendashqiptare, te na humbet edhe interesimi për të investuar në vendlindje.

Unë pesë vite radhazi po mundohem t'i bindi e të sjell investitorë të bizneseve tjera në vendlindje, por ata nga moszbatimi i ligjit heqin dorë nga investimet. Edhe institucionet administrative e bankare në Maqedoni janë ato që e pengojnë dhe demoralizojnë investuesin.

Në tërë botën vlen rregulli se për të qenë i pasur duhet të përpiqesh e të punosh, ndërsa këtu në Maqedoni ndodh e kundërta.

Shembull negativ është edhe fakti se për të marrë një kredi për ta zhvilluar më tej biznesin në Maqedoni, edhe pse janë para që vëhen në lëvizje për rritje të biznesit, duhet të paguash 18% tatim për shtetin, kjo për ne është e pakuptueshme dhe frenuese.Kjo don të thotë se shteti merr tatim për paratë që mi jep kredi për ta zhvilluar biznesin. Në Maqedoni nuk kuptohet dhe nuk ka barazpeshë as biznesi, as politika dhe as qëllimi i tyre.

Shembull tjetër absurd për mua është, se si Greqia fqinje e cila në vazhdimësi vepron ta shkatërrojë Maqedoninë, i ka ble të gjitha ndërmarrjet e rrëndësishme që kanë profit të sigurtë, si Fabrikën e Çimentos, Rafinerinë OKTA, Bankat, Telekomin, Vodafonin etj., ka bërë monopol dhe punon sipas diktatit të saj, duke ofruar edhe çmimet e shërbimeve më të larta në Evropë. Greqia e cila armiqësinë ndaj Maqedonisë e dëshmoi edhe me veton lidhur me emrin dhe pengoi kandidimin e Maqedonisë në NATO. Për mendimin tim kjo don të thotë shfrytëzum i rastit dhe i gjendjes nëpër të cilën kalon Maqedonia.

Shembull tjetër negativ është edhe fakti se, kudo në Evropë 1 tonelatë çimento kushton 49 euro, ndërsa në Maqedoni me tatim arrin afër 90 euro. E njejta gjë është edhe me mallrat që kalojnë nëpër doganat Greke.

Unë mendoj se liderët tanë duhet t'i kritikojnë e frenojnë këto dukuri ekonomike të dëmshme, e jo të merren me njëri-tjetrin.

Marrëveshja e Ohrit, u arrit pas derdhjes së gjakut dhe me shumë viktima e invalidë të luftës, prandaj ajo duhet të zbatohet pa vonesë dhe me përpikmëri".

JANULLATOSIN E KRITIKUAM ASHPËR

I pyetur për vizitën e fundit të Janullatosit në SHBA dhe për për reagimin e mërgatës shqiptare ndaj vizitës së këtij kleriku grek, Ibrahim Kolari, thekson se:" Me të mësuar se Janullatosi më 8 mars 2008, kishte ardhur në Boston për nder të 100 vjetorit të vdekjes së Fan Nolit, i bindur se po të ishte gjallë edhe vetë Noli nuk do të pranonte në asnjë mënyrë që ky prift grek të jetë i ftuar si mysafir nderi, dhe se ky prift grek vinte plot shpifje dhe propagandë antishqiptare, mora nismën që Shoqata Atdhetare Dibrane , të cilën e drejtoj, sëbashku edhe me shoqatat e tjera simotra politike shqiptare, dhe e kritikuam këtë person të rrezikshëm dhe priftin Artur Liolin, i cili e kishte ftuar si mysafir nderi, Janullatosin, i cili në vazhdimësi përpiqet që Shqipërinë ta bëjë Greqi. Kritikat tona të fuqishme i publikuam në stacionet e atjeshme televizive dhe në mediat e shkruara "Illyria"dhe "Bota Sot".

> "Unë jam duke investuar në Dibër tashmë 5 vite. Deritani kam investuar afër 1 milion euro.Investimin tim ia kam borxh vendlindjes, ku kam lindur dhe jam rritur. Malli për vendlindjen më shtyn që pasurinë, zotësinë dhe eksperiencën time ta sjell në vendlindje. Kam parë si bëjnë biznes kombet tjera që jetojnë në SHBA, si ata interesohen dhe investojnë në vendlindjen e tyre. Ndjehem shumë krenar që jam shqiptar e që jam dibran.

INVESTIMIN IA KAM BORXH VENDLINDJES

Në pyetjen tonë se çka e shtyn të investojë në Dibër, ai u përgjigj se:"Unë jam duke investuar në Dibër tashmë 5 vite. Deritani kam investuar afër 1 milion euro.Investimin tim ia kam borxh vendlindjes, ku kam lindur dhe jam rritur. Malli për vendlindjen më shtyn që pasurinë, zotësinë dhe eksperiencën time ta sjell në vendlindje. Kam parë si bëjnë biznes kombet tjera që jetojnë në SHBA, si ata interesohen dhe investojnë në vendlindjen e tyre. Ndjehem shumë krenar që jam shqiptar e që jam dibran.Dibranët në përgjithësi kanë vlerë të madhe, ata kanë treguar zotësi e patriotizëm edhe për fqinjët. Çdo dibran gjatë historisë por edhe tani ka dëshuar kulturë, zotësi dhe dinjitet".

KANDIDATËT PËR PRESIDENT NË SHBA I RESPEKTOJNË SHQIPTARËT

Lidhur me qëndrimin e mërgatës shqiptare ndaj kandidatëve që garojnë për president në SHBA, ai spjegon se:" Kandidatët që garojnë për kryetar të SHBA-ve janë në favor të kombit shqiptar.Ky rast duhet shfrytëzuar pasi koha dhe momenti i sotëm shkojnë në favor të shqiptarëve.Ne duhet të jemi të kujdesshëm ndaj qëndrimit të shtetit amerikan, i cili na ka dalë në ndihmë rreth çështjes së përgjithshme shqiptare, e sidomos me rastin e Pavarësisë së Kosovës.



Në foto: Ibrahim Kolari

Dëshiroj tu bëj një urim tërë shqiptarëve për shtetin e ri të Kosovës që u deklarua më 17 shkurt dhe për Kushtetutën më 15 qershor të këtij viti , ku edhe unë mora pjesë në delegacionin e kryesuar nga Eliot Engël dhe kongresmenja Mis Smit".

SH.A.D ME PLOT AKTIVITETE TË DOBISHME

Për aktivitetet e Shoqatës Atdhetare Dibrane, Ibrahim Kolari, thotë se:"Aktivitetet e shoqatës këtu janë të shumta dhe të rëndësishme për komunitetin dibran e më gjerë. Shoqata viteve të fundit ka filluar të sjell besim më të madh te dibranët dhe mërgata mbarëshqiptare, gjë që dëshmohet me anëtarësimin dhe me aktivitetet tona që gjithnjë vijnë në rritje.Viteve të fundit shoqata i ka dyert e hapura në të gjitha institucionet e administratës amerikane, e cila shkon në favor të shqiptarëve dhe të shoqatës. Ne kemi krijuar miqësi dhe marrëdhënie bashkëpunimi me Institucionin e emigracionit, me Zyrën e avokatit shtetëror që është është në mbrojtje të ligjit, me kongresmenë të ndryshëm etj.".

DIBRA PRET NDIHMËN E TË GJITHËVE

Në pyetjen se çduhet bërë në të mirë të Dibrës së Madhe , Ibrahim Kolari, thotë se:"Siç jam shprehur edhe më parë në Dibër të Madhe është më se e nevojshme që pushteti vendor, policia, gjyqësia, prokuroria dhe Myftiu, të ulen e ta vendosin sëbashku ardhmërinë e këtij qyteti, të cilin unë sot e shoh si qytet të lënë pas dore, si shtëpi pa zot shtëpie.Kam propozuar që këtyre faktorëve të sipërpërmendur tu bashkangjiten edhe aktivistë nga diaspora, sepse përveç ndihmës financire që shumë mëgimtarë u dërgojnë familjeve të tyre, ne ndjejmë edhe obligimin moral për zhvillimin sa më të shpejtë ekonomik të Dibrës së Madhe .Ne kemi fituar eksperiencë, kemi atdhedashuri për vendlindjen dhe jemi të gatshëm që këto edhe t'i materializojmë"..Mirëpo për fat të keq intervista dhe mesazhet tona arrijnë në vesh të shurdhër", tha në fund tëbisedës Ibrahim Kolari.

Rexhep TORTE

Stop kaosit nga ndërtimet, nis hartimi i masterplanit për Peshkopinë

Pas plot 17 vjetësh tranzicion, më së fundi mund të themi se tashmë do t'i jepet fund kaosit të ndërtimeve pa kriter dhe pa asnjë lidhje arkitektutore në Peshkopi. Së shpejti qyteti, dikur i njohur për veçantinë e ndërtesave, do të ketë një plan zhvillimi për gjithë territorin e tij. "Për herë të parë në planin e ri rregullues do të përcaktohet qartë edhe drejtimi i shtrirjes së qytetit, thotë drejtuesi i zyrës urbanistike në Bashkinë Peshkopi, Ajet Braha. Ai sqaron se më në fund ky institucion ka vendosur që në shtator të këtij viti do të nisë puna për hartimin e planit rregullues të qytetit verilindor.

Mungesa e deritanishme e një plani të tillë, si dhe bumi i ndërtimeve, kanë krijuar një kaos të vërtetë në Peshkopi. Po sipas urbanistit të Bashkisë, gjithçka do të shikohet në prespektivë për të ardhmen. / **M. Lala**

Bulqiza me syrin e një jodibrani, por që kur qëndron me dibranët bëhet me dibran se ata. Një reportazh për anët tjetër të qytetit të minatorëve: **pasuritë shpirtërore të njerëzve dhe shpresa për ringjalljen e qytetit....**

Pasuria njerëzore e BULQIZËS



Nga
VIRON KONA



Bulqiza, mjaft e pasur në krom, por akoma më e pasur në vlera njerëzore.

Mbresa nga Bulqiza dhe nga shkolla 9-vjeçare "Xhevdet Doda"

Për këtë shkrim u bë shkas zhvillimi në Bulqizë i një seminari trajnues me mësuesit që japin lëndën e edukatës në klasat e teta. Kisha qenë kalimthi në Bulqizë dhe dija se qyteti është afro 1000 metra mbi nivelin e detit, që aty ndodhet një nga vendburimet më të mëdha të kromit dhe, sigurisht, kam lexuar dhe dëgjuar shpesh për njerëzit e, sidomos kam përjetuar me dhembje aksidentet dhe humbjet e jetëve të mjaft minatorëve dhe punëtorëve në minierën e kromit. Ato dy ditë të qëndrimit aty i dhashë më shumë krahë mendimit se, të njohësh një trevë, krahinë apo qytet, duhet të njohësh në radhë të parë jetën dhe trashëgiminë kulturore, botën shpirtërore dhe zakonore të banorëve. Teksa, duke punuar në sektorin e arsimit, kisha edhe privilegjin të njihja nga afër fisnikërinë e mësuesve dhe botën gjithnjë befasuese dhe të çiltër të fëmijëve. Por, kisha edhe një avantazh tjetër plus, sepse dy kolegë të mi Shemsi Muça dhe Besnik Rama (specialistë të arsimit në MASH) janë me origjinë nga kjo trevë e mbushur plot me histori dhe me banorë mikpritës, bujarë e arsimdashës. Prandaj, veçanërisht Shemsiun, por edhe Medinin (ky, specialist i ZA Bulqizë) i "lodha" me pyetjet e shumta që u bëja gjatë pushimeve pasdite të aktivitetit tonë, teksa i tërhiqja që të shkonim në këmbë: "Ja, deri atje tek vendet ku u zhvilluan betejat e Vajkalit", te "gurët dhe lapidari i Skënderbeut"..., e, ndërkaq ngjitesha në vende disi të lartë dhe fotografoja peizazhet e rrallë e befasues që na rrethonin gjithandej e që më tërhiqnin me pamjen disi të ashpër, të thyer, mitologjike dhe madhështore.

* * *

Lugina e Bulqizës është si një udhë natyrore që lidh Dibrën me luginën e Matit. Ajo ka një pasuri të çmuar dhe të pasur historike e kulturore, etnografike e gjuhësore. Aty befasohesh nga ngjarjet që dëgjon në biseda të thjeshta dhe që vijnë si jehonë nga lashtësia ilire arbërore, nga periudha e Skënderbeut e deri në ditët tona. Sapo ndeshesh me relievin e thyer të maleve në dy anët e luginës, të tundon dëshira për të qëmtuar e mësuar sa më shumë për këtë trevë historike, ende të paeksploruar nga arkeologët. Fakti që mjaft zbulime arkeologjike të kohëve të fundit janë bërë fare spontanisht, të bëjnë të besosh se organizimi i ekspeditave arkeologjike, historike e studimore do të evidentonin mjaft të panjohura aq të dëshirueshme, duke plotësuar më tej hartën arkeologjike dhe historike të lashtësisë shqiptare me më shumë objekte dhe fakte historike. Në vijim të kësaj ideje, më duket se është një botim mjaft dinjitoz, informues, sensibilizues dhe intrigues gazeta "Rruga e Arbërit", ku lexuesi gjen shkrime cilësore, që do t`i kishin zili edhe mjaft nga gazetat që botohen në vendin tonë. Në vijim të këtij opinioni, kam dëshirë të përmend shkrimet e Adem Bungurit, që transmetojnë vlera historike e arkeologjike dhe të mjaft autorëve të tjerë dibranë.

Kur ndodhesh në Bulqizë, nxitesh natyrshëm për të mësuar më shumë hollësi për vendbanimet e hershme ilire arbërore të vendosura (tashmë mjaft prej tyre të zbuluara) në kodra disi të larta, me mbrojtje natyrore apo dhe të përforcuara me sisteme fortifikuese, siç ka qenë p.sh kalaja e Krajkës, gjurmët e së cilës gjenden në një kreshtë malore, më vonë kalaja e Sofraçanit, qyteza e Fushës së Gurës (Stirçkan), ajo e Urës së Qytetit (Peladhi), e Homeshit... Ndërkaq ndihesh po aq i interesuar të mësosh akoma më shumë për Rrugën e re të Arbërit, që parashikohet të jetë një ndër rrugët më të bukura turistike në trevat shqiptare (Tiranë - Dibër, vetëm 75 km e gjatë, ndërsa ajo ekzistuese është 183 km). Kurse qyteti i Bulqizës do të jetë vetëm 50 km larg Tiranës. Kjo rrugë është mjaft e lashtë, ashtu si dhe Vija Egnatia, madje, siç shprehen historianët, kjo mund të konsiderohet si pjesë apo si degë e saj. Me ndërtimin e kësaj rruge do të marrin zhvillim të ri të gjithë trojet ku banojnë shqiptarët në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë.... Në Bulqizë dëgjon histori, legjenda dhe toponimet interesante të vendeve dhe nxitesh nga dëshira të dish akoma më shumë për Qafën e Buallit, e cila njihet si porta perëndimore e Dibrës dhe si kufi gjeografik midis Dibrës dhe Matit dhe që rruga e re e Arbërit do ta përshkojë këtë Qafë nëpërmjet një tuneli prej 800 metra të gjatë. Pastaj natyrshëm interesohesh për luginën e Vajkalit dhe etimologjinë mjaft interesante të këtij emri, që shpjegohet me lotët (vajin) e kalit të Skënderbeut, i cili duke kapërcyer në shkëmb theu këmbën dhe nisi të lotonte nga dhembja fizike, por edhe sepse nuk po e çonte Zotin e tij atje për ku ishin nisur. Sikurse entuziazmohesh me zbulimin fare rastësisht në fshatin Sofraçan të dy përkrenareve bronzi të tipit ilir, përkrenare këto që i mbanin ushtarakët ilir madhorë, gjë që dëshmon për organizimin e lartë të ushtrisë ilire... E, ashtu duke bashkëbiseduar fjala shkon natyrshëm te legjenda e Gurëve të Skënderbeut, tek etimologjia e emrit Peladhi, te vendbanimet e hershme të Zerqanit, Fushë - Bulqizës, Gjoricës, Okshtunit, Ostrenit... dhe legjendat rreth tyre, te Golloborda dhe mjeshtrit e saj mjaft të njohur të ndërtimit brenda dhe jashtë vendit, te liqenet e mrekullueshëm malorë, ku siç dëgjova në biseda, bulqizakë me dashuri për këtë trevë dhe turizmin, ideojnë dhe projektojnë në mendime dhe më pas në veprime deri edhe një teleferik që do të bënte të mundur vizitën nga turistët vendas dhe të huaj të liqeneve të mrekullueshëm akullnajorë...

* * *

Të vjen mirë kur dëgjon se në sfondin e pasur historik e arkeologjik të Bulqizës, mësuesit e shkollave, veçanërisht ata të historisë, gjeografisë, letërsisë, kanë orientuar dhe kanë tërhequr vëmendjen e nxënësve te këto zbulime, duke zhvilluar me ta biseda rreth të kaluarës së lashtë ilire e, veçanërisht, për periudhën e lavdishme të Skënderbeut, ku Bulqiza përmendet për disa nga betejat e njohura të Heroit tonë Kombëtar si beteja e Torviollit (qershor 1444), dy betejat e Vajkalit (Prill dhe Gusht 1465) etj. Në Bulqizë gjen një botë të pasur plot legjenda, fjalë të urta, tregime popullore të rralla dhe të mrekullueshme, të cilat janë mbledhur dhe botuar rreth 25 vjet më parë nga Instituti i Kulturës Popullore, (përgatitur nga studiuesi dhe folkloristi i shquar shqiptar Qemal Haxhihasani në librin e tij "Epika Historike 1"). Kërkesat dhe dëshirat e mia për të ditur e mësuar sa më shumë vijojnë të pafundme, sidomos duke u drejtuar pyetje kolegëve të Zyrës Arsimore: Agimit, Halilit, Rajmondit: për një hartë të Bulqizës dhe të rrugës së re të Arbërit, për disa të dhëna demografike, për zhvillimin e arsimit dhe shkollat e rrethit, për ndryshimet klimaterike dhe efektet e ngrohjes globale në këtë zonë, dikur mjaft të ftohtë, me depozitime kënetore, ku specialistë dhe teknikë të huaj bashkë me pajisjet për minierën sillnin me vete dhe patina për të rrëshqitur në akull...

* * *

Atë mëngjes, duke ecur në rrugën kryesore të Bulqizës, na tërhoqi vëmendjen gjallëria e fëmijëve përballë shkollës 9 - vjeçare "Xhevdet Doda", e cila ndodhet në një pozicion interesant gjeografik, vendosur në luginën e



Bulqizës, në lagjen "Minatori". Shpejt mësova se aty zhvillohej një kros masiv nga nxënësit e kësaj shkolle në praninë e mësuesve, drejtuesve të shkollës dhe mjaft banorëve të qytetit. Ky kros ishte i inkuadruar në Javën Olimpike dhe ishte shoqëruar edhe me aktivitete të tjera sportive si kërcime aerobike, ndeshje hendbolli, volejbolli... Në krye të këtyre aktiviteteve ishin mësuesit e pasionuar të edukimit fizik Violeta Kurti dhe Jashar Shehu, teksa pas krosit, ne përjetuam bashkërisht gëzimin dhe emocionin e nxënësve fitues: Eneas, Johanës, Erjonit, Mirjanës, Fatosit, Luizës, Nazifit, Sidorelës...

* * *

Përshtypja që më shkaktoi aktiviteti sportiv plot bukuri e gjallëri i atij krosi atë mëngjes, më nxiti të shkruaj edhe për punën që bëhej në shkollën "Xhevdet Doda", e cila ka një moshë 60 vjeçare dhe është një nga shkollat e para të Bulqizës. Nga bankat e saj kanë dalë njerëz të nderuar dhe me emër, kuadro në qytet e nëpër atdhe e, deri edhe deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë bisedës, zëvendësdrejtori i kësaj shkolle z. Selman Alla, duke treguar drejtoreshën znj. Albana Balla, më thotë se Albana ka qenë nxënëse e kësaj shkolle. Më pas, për 10 vjet, ajo ishte mësuese e, tani, prej tre vjetësh vijon punën si drejtoreshë e shkollës. Ndjej respekt kur shoh se stafi drejtues i kësaj shkolle, me drejtoreshë Albanën, zëvendësdrejtor Selmanin, zëvendësdrejtor Fiqiri Duriçin dhe këshillin e mësuesve,

(Vijon në faqen 10)



Mësuesit e shkollës 9-vjeçare, "Xhevdet Doda"

> Kur ndodhesh në Bulqizë ... ndihesh i interesuar të mësosh më shumë për Rrugën e re të Arbërit... Qyteti do të jetë vetëm 50 km larg Tiranës. Me ndërtimin e kësaj rruge do të marrë zhvillim të ri Bulqiza dhe gjithë trojet ku banojnë shqiptarët në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë....

shënime

Lushnja pret **valltarët e rinj** nga gjithë trevat shqiptare.
Mbreti i Festivalit, **Besmir Aga** nga Dibra

Kur kërcejnë dibranët, bëhen mbretër...



Shënime në mbrëmjen e 30 majit 2008, në Lushnjë

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Një miku im, lushnjar, kur pas një udhëti mi dymbëdhjetë orësh, natën, nën ison e këngës labe nga Athina në Myzeqe, iso që herë zgjohej e herë dremiste për të marrë forcë, pasi më takoi në sheshin qendror të Lushnjës më tha se ishte njohur me një dibran...

Qesha dhe i thashë se në Lushnjë ka kaq shumë dibranë, nga ata që i prunë dhe nga ata që erdhën...

Edhe ai qeshi duke shtuar se fjala ishte për një shokë të vjetër timin...

E pyeta se si e kishte emrin...

Më tha se nuk e kishte mësuar...

Kështu do të kalonte dita e 30 majit: në takime, biseda me të njohur të vjetër e të rinj, para një filxhani me kafe apo një shisheje të vogël me dhallë...

...Kur u mblodhëm e bëmë vend në radhën e rezervuar për ne, miku im, duke më tundur krahësh, zgjati dorën drejt një njeriu...

Ishte vërtet një shoku im i vjetër. Them "i vjetër" në qoftë se do ta quaj "të vjetër" hapësirën e dymbëdhjetë vjetëve ndarë e të pa parë. E kisha "parë" atë ditë në mëngjes kur në një album me histori të festivalit të valles folklorike tipologjike kombëtare i kishin bërë vend në një faqe me ngjyra si "mbret" i veprimtarisë tashmë "pronë" e Lushnjës. Nuk pata kohë të thellohem në tiparet që shprehte fotografia se dikush ma mori nga dora...

Tani kam kohë ta shoh, madje ta prek, madje ta përqafoj me mall duke i pështpëritë në vesh ndonjë nga ato fjalët që rron thellë e kujton gjatë. Mos prisni tua them. Ato i dimë Unë dhe Ai...

Mua natyra ma "shpyllëzoi" kokën. Shaban Xhajkut natyra ia kishte mbuluar me dëborë. Nuk e di nga e kishte marrë; nga Korabi, Prati e Kunora e Lurës ku kemi "ngarë revan" apo nga Valivari e Bjeshkët e Hynoskës mëngjeseve të fëmijërisë së tij parë nga Trena..

Pak më tutje Veli Vraniçi, i shkurtër (kur është pranë Shabanit), por i gjatë, shumë i gjatë (kur është pranë këngës e valles), Veliu që i qeshin sytë e i gëzohet zemra, njeriu që ta ngjit mallin e gëzimin...

Kaq për ta, nga unë, shoku dhe miku i tyre në mërgim, njeriu që i mungon Dibra dhe ia ngrenë zemrën peshë dibranët, ata që i dua dhe më duan...

Po ata çfarë thonë? Jo për mua, por për festivalin...



Shaban Xhajku: Është hera e tretë që vijmë. Kësaj radhe erdhëm me dy valle vajzash. Është një valle e vajzave të Zerqanit. Quhet e vajzave të Zerqanit, sepse ato në Zerqan nuk venë shami në kokë. Erdhëm edhe me një valle të Zall – Dardhës. Vajzat këtu mbajnë shami.

Vallja e dytë është valle dyshe. Janë dy valle dyshe. Është e "Koxhaxhikut" dhe e "Thuprës së Fushës" që e kërcejnë Besmir Aga dhe Saimir Xhajku. Ndërsa "vallet e treta", i quaj të treta sepse janë disa valle, disa breza, janë të Matit. Në fund e mbyllim me vallen e Zall – Dardhës.



Veli Vraniçi, drejtor i Qendrës Kulturore Peshkopi:

Si udhëtuat nga Peshkopia ?

Udhëtuam shumë mirë, megjithëse, kush e ka marrë veshtë, nga Shupenza deri në Bulqizë punohet, por pavarësisht nga tronditjet e shijojmë gëzimin se do të kemi një rrugë të re, Rrugën e Arbrit.

Edhe kjo intervistë është për gazetën "Rruga e Arbrit". Çfarë sollët në Lushnjë?

Kemi sjellë një çift shumë interesant në "Vallen e Koxhaxhikut" dhe "Thuprës dibrane".

Si është jeta kulturore në Dibër?

E gjallë. Unë mund t'ju them vetëm kaq: Është nga të paktët qytete që ka kaq shumë aktivitete me shumë pak mbështetje financiare. Bën tre – katër premiera estrada, dy - tre premiera ansambli, një premierë teatri, pavarësisht nga veprimtaritë e tjera si promovime, fjala artistike, data historike për muzeun, veprimtari e gjerë e bibliotekës, pa llogaritur këtu veprimtarinë tashmë të njohur mbarëkombëtare "Oda dibrane"...

* * *

Dibrën e ftojnë në skenë. Të parën në natën e tretë të festivalit. Mbi Lushnjë ka rënë muzgu i një mbrëmje të ngrohtë pranvere... Dy prezantuesit, një vajzë dhe një djalë, simpatikë në pamje e melodikë në zë prezantojnë...

Vajza: Ka ardhur Dibra me valle legjendash....

Djali: Program i Grupit të Dibrës. Valle vajzash e Zerqanit: Kërcejnë Manjola Xhidra, Elca Torba, Fike Koçja dhe Dorina Mandri. Në curle: Pëllumb Osmani, në lodër Shemsi Tahiri. Valle e Koxhaxhikut dhe e Thuprës së Fushës: Kërcejnë Besmir Aga dhe Saimir Xhajku. Valle dyshe burrash matjane. Kërcejnë Sadik Gaçi, Ramazan Tafa, Algert Xhetani, Emiliano Lela dhe Xhemal Alia. Valle grash e Zall – Dardhës. Kërcejnë "Grupi i Vajzave"...

Pas kësaj mbi skenë mblidhen dhe përhapen, si lulet në livadhe, djem e vajza...

...Nuk do të shkruaj më gjatë. Më mbytën dhe më mbysin emocionet e trevës ku linda, Dibrës, e trevës së gjerë ku punova dikur si gazetar i ATSH-së, të atyre vendeve që sot i quajnë "Qarku i Dibrës"...

Po i përcjell më mirë në pamje të gjalla fotografike, ashtu siç i fiksova në prova dhe në konkurrim...

Athinë, qershor 2008
E-mail: a_ashiku@yahoo.gr
00306938103747.

MBRETI DHE MBRETËRESHA E FESTIVALIT

Skënder Selimi, kryetar i Jurisë në fjalën përmbyllëse për vlerësimin në grupe dhe individë ndër të tjera tha:

...Është menduar që në këtë festival të kemi dy pika të larta, "Mbretin" dhe "Mbretëreshën" e festivalit...

"Mbret" i festivalit shpallet Besmir Aga i grupit të Dibrës.

"Mbretëreshë" e festivalit shpallet Matilda Gjunçaj e grupit të Tuzit të Malit të Zi...

Një "Mbret " dibran, Besmir Aga, djali i Bexhetit dhe nipi i Baftjarit të njohur të punës e të ndershmërisë...

Një "Mbretëreshë" tuziane, nga Tuzi i largët në Veri, copë e Shqipërisë nën Malin e Zi... I vura pranë e pranë, një "Mbret" dhe një "Mbretëreshë" nën një fotografi...



Nderohet Hazis Ndreu



Në 80-vjetorin e lindjes, nderohet vepra e "Mjeshtrit të Madh" që lëvroi në rapsodi, koreografi, histori, etnografi etj.

Tek ai, arti gërshetohet në mënyrën më brilante. Ka shkelur në të gjitha gjinitë e tij dhe ka lënë gjurmë. Këngëtari, aktori, rapsodi, historiani dhe etnografi, Hazis Ndreu, festoi 80-vjetorin e lindjes, pa praninë e tij fizike, por me dashurinë e shumë miqve të familjes e artistë, dashamirës të tij, të cilët u mblodhën në Qendrën Kulturore të Ushtrisë në Tiranë dhe e kujtuan me respekt. Teksa dëgjon emrin e tij nuk ka se si të mos të kujtohen rapsoditë e bukura të Dibrës, që vijnë në sfond sapo ndriçohet skena. Por jo vetëm kënga, edhe vallet e mrekullueshme, poezitë dhe studimet për Skënderbeun do të mbeten gjithmonë në mendjen e shqiptarëve.

Moikom Zeqo, Afërdita Jonuzi, Edmond Zhulali, Arjan Kadiu, Agim Doci, etj., në referimet etyre vunë në pah talentin dhe aftësinë e pakrahasueshme të Hazis Ndreut.

"Studimi i tij për Skënderbeun, përmes toponimeve dhe gjurmimeve në zonën e Dibrës, nuk ka qenë vetëm një shkencë e terrenit. Për Skënderbeun ka disa studime të tipit gojëdhënor, por studimi i Hazis Ndreut është diçka e re dhe serioze, që më ka bërë shumë përshtypje. Janë studime që lidhen me veriun dhe jugun e vendit, ndaj të gjithë studiuesit duhet të marrin për bazë këtë libër dhe këtë studim të Hazis Ndreut", theksoi Moikom Zeqo.

Kujtimin e Hazis Ndreut e përcollën me këngë e humor edhe këngëtarët Caje Poleshi, Qerim Sula, Ingrit Jushi, por edhe humoristët Behar Mera, Veli Rada, Skënder Sallaku, etj.

Vendburimi i mineralit të çmuar u diktua nga një gërmues popullor më 1940. Miniera u krijua më 18 shkurt 1948. Që nga ajo kohë, janë hapur 800 km tunele e galeri dhe janë nxjerrë e eksportuar jashtë vendit mbi 13 milion ton mineral krom.

Pasuria njerëzore e Bulqizës



Bulqizë, "Qyteti i Ri"

(Vijon nga faqja 8)

drejtojnë e zbatojnë me nivel cilësor programin mësimor edukativ të shkollës dhe shkolla vijon rrugën e traditave të saj, duke nxjerrë vazhdimisht nxënës që e bëjnë përherë e më të njohur emrin e saj me rezultatet që ata arrijnë jo vetëm aty, por edhe në shkollat ku shkojnë për të vazhduar më tej studimet, si në shkollat e mesme të Bulqizës, ashtu edhe në shkollat e mesme apo dhe të larta të vendit. Edhe më parë, por edhe në këto vite, në këtë shkollë vijnë letra falënderimi nga drejtoritë e shkollave të mesme si ajo Tregtare e Vlorës, e Gjuhëve të huaja dhe Teknike të Tiranës, ku letërshkruesit shprehin falënderimet e tyre për nivelin e përgatitjes dhe cilësitë e dallueshme të nxënësve të "Xhevdet Dodës". Stendat e vendosura në mure tregojnë fituesit e shkollës në konkurse dhe olimpiada brenda rrethit dhe në ato kombëtare, aktivitetet e shumta kulturore, artistike, folklorike dhe sportive, por stendat pasqyrojnë edhe aktivitetet me më të talentuarit e shkollës në fusha të ndryshme, me krijuesit e interpretuesit e rinj të organizuara nga mësuesit e gjuhës, leximit, muzikës, kimisë, fizikës, sikurse, në stenda shkruhet për konkurset në gjuhën frënge, për njohjen e lirive dhe të drejtave të fëmijëve etj. Mësues dhe drejtues e kanë me merak të përmendin olimpiadat e matematikës nga klasat e dyta deri në klasat e teta, ku morën pjesë 115 nxënës dhe ku për fituesit u ndanë çmime, u shpërndanë certifikata e dhurata të ndryshme simbolike, por ata ngulmojnë të shkruajmë edhe për festën e bukur e plot emocion të Abetares, e cila u zhvillua në të gjitha klasat e para... Shkolla përkujton çdo vit edhe festën e minierës. Dhe aty mësoj se vendburimi i mineralit të çmuar u diktua nga një gërmues popullor më 1940. Miniera u krijua më 18 shkurt 1948 dhe filloi nxjerrja e kromit. Që nga dita e krijimi janë hapur 800 km tunele e galeri dhe janë nxjerrë e eksportuar jashtë vendit mbi 13 milion ton mineral krom. Bulqiza zë vendin e tretë në botë si eksportuese dhe prodhuese e kromit.

* * *

Drejtoria e shkollës ka statistika të qarta dhe të sakta të nxënësve me nevoja të veçanta, si ata me vështirësi ekonomike, me prindër të divorcuar e, sidomos, për ata nxënës që kanë mbetur jetimë. Në mënyrë të herëpashershme me këta nxënës zhvillohen takime të ngrohta e aktivitete kulturore artistike dhe sportive, ku ata ndihmohen me qëllim që t'u lehtësohen dhembjet që kanë pësuar apo vështirësitë e jetesës. Mund të themi se larmia dhe vijueshmëria e këtyre aktiviteteve është një tjetër e veçantë për t'u përgëzuar e kësaj shkolle, e mësuesve dhe drejtuesve të saj. Madje, të krijohet ndjesia se edhe zyrat që merren me statistika do të kishin zili mbajtjen aq saktë dhe të rregullt të dokumentacionit dhe evidencave vit pas viti të frekuentimit, të përparimit të nxënësve, të ciklit të ulët dhe të lartë apo dhe për çdo vit shkollor. Kështu ndiqen dhe krahasohen rezultatet e 781 nxënësve (396 të ciklit të ulët dhe 385 të ciklit të lartë), nxirren detyra dhe konkluzione për ecurinë e mëtejshme të shkollës si dhe të gjithë problemet që ka ajo. Punë të veçantë këtu bëjnë departamentet, sidomos ato të matematikës dhe të ciklit të ulët. Atmosfera që krijohet në shkollë është e ngrohtë dhe nxitëse për 34 mësuesit dhe për nxënësit që ata të arrijnë vazhdimisht rezultate gjithnjë e më të mira. U bënë disa vite që në këtë shkollë nuk ka asnjë nxënës braktisës, ekziston një bashkëpunim e mirëkuptim i plotë i shkollës me komunitetin dhe me pushtetin vendor, sidomos me bashkinë, ku edhe kryetari i saj z. Roland Keta ka qenë nxënës i kësaj shkolle. Gjithçka që bëhet në shkollë, vihet në funksion të mësimit dhe të edukimit, duke e bërë "Xhevdet Dodën" një nga shkollat e njohura jo vetëm në Bulqizë, por edhe në Qarkun e Dibrës. Edhe një ekip i M A Sh - it, i cili ka kontrolluar veprimtarinë e kësaj shkolle, e ka vlerësuar punën që bëjnë këtu mësuesit dhe stafi drejtues.

* * *

Thuajse në të gjitha bisedat me drejtues dhe mësues të shkollës, me specialistë e drejtues të Zyrës Arsimore e prindër të nxënësve përmendet me respekt të veçantë puna plot përkushtim e ish zëvendësdrejtorit të kësaj shkolle z. Musa Vladi, i cili u nda nga jeta afro një vit më parë. Gjurmët e punës së atij njeriu të mirë, aktiv e të lidhur mjaft ngushtë me shkollën, i gjen në shumë mjedise të saj. I gjen ato në evidencat dhe statistikat që ndjekin në mënyrë shembullore ecurinë e shkollës, në stendat, fotografitë e rubrikat e zgjedhura e të realizuara prej tij e të vendosura në mure, i sheh në dhomën muze të shkollës, ku me një pasion të veçantë ai ka bërë të njohur e renditur historinë e pasur të shkollës që nga themelimi i saj dhe në vazhdimësi. Nuk harrohen nga mësuesit dhe nxënësit veprimtaritë e organizuara prej Musait për të drejtat e njeriut, për parandalimin krimeve, për sigurinë rrugore, për nxënësit me nevoja të veçanta, për mjedisin...Ai mbetet ideatori i krijimit të muzeve nga niveli i shkollës, në atë të qytetit dhe të rrethit...Një stendë e bukur dhe e veçantë në korridorin e shkollës i kushtohet Musa Vladit, njeriu të talentuar dhe aq të dashur për të gjithë, i cili më shumë sesa në stenda e historikë, ka mbetur si një kujtim i rrallë në mendjet dhe shpirtin e kolegëve të tij mësues, të komunitetit dhe të nxënësve të tij të dashur që ai i donte aq shumë.

(Fotot që ilustrojnë këtë shkrim janë të autorit, Viron Kona)

HISTORIKU I ARSIMIT NË KALA TË DODËS



Nga
METUSH SKEJA

Kalaja e Dodës ka njerëz arsimdashës. Nga kjo zonë kanë mbaruar arsimin e lartë mbi 100 veta.

Gjatë sundimit turk fëmijët mësonin tek hoxha i fshatit. Kulmin e vet mejtepet e patën në fillim të shekullit XX, kur kthehen pas studimesh në Stamboll dy vëllezërit Ferati nga Radomira Vebiu dhe Tahiri, të diplomuar për dokrinë islame.

Shkolla e parë shqipe hapet në vitin 1922 në fshatin Ploshtan. Mësuesi i parë ka qenë Besim Dalliu nga Tirana. Shkolla hapet pas aktivit kombëtar të arsimit të vitit 1922, që është aktivi më i rëndësishëm në historinë e arsimit kombëtar. Pati mbështetjen e Hasan Prishtinës, që ishte edhe deputet i zonës së Drinit. Mësonin kryesisht djemtë nga fshatrat Ploshtan, Ceren, Radomirë, Vasije dhe Shullan.

Në vitin 1938 në fshatin Rade hapet një klasë mësimi me mësues Alush Abazin. Në Kalis shkolla shqipe hapet në vitin 1922. Shkollat qëndrojnë të hapura deri në vitin 1939 me pushtimin fashist të vendit.

Në tetor të vitit 1944, pasi forcat partizane çlirojnë vendin, rihapen shkollat shqipe në Ploshtan me mësues Rifat Domi në Ceren, Radomirë, Tejes, Kalis, Vile, në Gjegjan me mësues Qazim Domi, në Fshat me mësues Ahmet Brika. Në Çaje shkolla hapet në vitin 1947.

Në vitin 1948 në Ploshtan mbi rrënojat e kalasë së mesjetës së mesme tek Hoteli i shtetëzuar i Rifat Gjonllakut hapet klasa e pestë e arsimit shtatëvjeçar. Klasa kishte 14 nxënës, të ardhur nga Bushtrica, Çaja, Kalisi 6 veta e Kalaja. Ndërtesa e shkollës ishte dykatëshe me 9 dhoma, me dysheme dërrase. Drejtor ka qenë Qamil Hoxha, mësues Qazim Kuqashi nga Elbasani. Më pas drejtor ka qenë Enver Onuzi e Halim Shehu. Në vitin 1953 në Bushtricë hapet shkolla shtatëvjeçare, klasa e pestë.

Në vitin shkollor 1954-1955 shkolla e Ploshtanit kishte këto mësues: Eqerem Kruja, drejtor; Iljaz Lumani, mësues biologjie, i cili ishte nga Bosnja, i mbetur në Shkodër. Më pas ai bëhet drejtor i Bankës Kombëtare – Sarajevë; Gani Iskuka, mësues matematike; Veli Spata, mësues fizike; Maliq Lika, mësues historie; Xhemali Haraçiu, mësues gjeografie; Fehmi Xhepa, mësues gjuhë-letërsi; Xhemal Cala, mësues fillore; Axhem Sufa, mësues fillore.

Në vitin 1956 shkolla 7/vjeçare transferohet në Ceren, ku ishte klasa e pestë, e gjashtë dhe e shtatë. Mësonin nxënës nga gjithë zona e Kalasë. Ka qëndruar për 10 vjet në Ceren.

Në vitin 1965 përsëri klasat e larta të arsimit të detyrueshëm kalojnë në Ploshtan. Në vitin 1966 krijohet klasa e pestë për fshatrat Ceren, Tejzë, Kullas, Ujmirë, Radomirë. Krijohen dy drejtori shkollash: njëra ne Ploshtan dhe tjetra në Radomirë.

Shkolla e parë shqipe hapet në vitin 1922 në fshatin Ploshtan. Mësuesi i parë ka qenë Besim Dalliu nga Tirana. Shkolla hapet pas aktivit kombëtar të arsimit të vitit 1922, që është aktivi më i rëndësishëm në historinë e arsimit kombëtar

Në vitin 1976 në Ceren hapet shkolla e mesme, klasa e 9-të, profili Agronomi me tre herë në javë pasdite. Për shkak mungese kontingjentesh, ajo mbyllet pas dy muajsh.

Në vitin 1981 rihapet përsëri në Ceren. Mësim jepnin mësuesit e shkollave tetëvjeçare Ploshtan dhe Radomirë. Kishte 20 nxënës profil Agronomi. Në vitin 1983 krijohet Drejtoria e shkollës së mesme me godinë të re në Ceren. Drejtori parë i shkollës ka qenë Metush Skeja, me UT, dega biologji dhe me studime pasuniversitare për psikologji – pedagogji.

Në shtator 1983 kjo shkolle kishte këto mësues: Metush Skeja, drejtor; Tajar Domi, zootekni; Fadil Daku, matematikë; Rushit Kraj, fizikë; Iljaz Palushi, letërsi; Fiqiri Farruku, agronomi.

Nga shkolla e mesme Ceren kanë dalë 9 matura. Matura e parë e vitit 1985, e fundit në vitin 1995. Në vitin 1994 nuk ka pasur maturë. Gjithsej kanë mbaruar 150 veta arsimin e mesëm. Nga këto 40 veta kanë mbaruar arsimin e lartë. Dy matura kanë qenë agronomi, matura e fundit gjimnaz, të tjerat zootekni.

Metush Skeja ka qenë drejtor i shkollës së mesme nga viti 1983 deri në vitin 1992, për 9 vjet rresht, më pas një vit Fadil Daku. Në vitin 1992-1995 ka qenë Iljaz Palushi.

Nxënësit që mbaronin shkollën e mesme Ceren konkurronin shumë mirë me programet e shkollave të larta që ndiqnin. Mësues të ardhur nga rrethe të tjera kanë qenë: Ismet Kuteli nga Dukati – Vlorë, Petro Koçi – nga Fieri, Leo nga Narta, Fiqiri Farruku nga Durrësi, Hajri Gurabardhi nga Tirana. Në vitin e fundit shkolla e mesme kishte këto mësues: Iljaz Palushi – drejtor, Metush Skeja – biologji kimi, Fetah Cala – matematikë, Isa Lita –Fizikë, Burbuqe Domi, Jahe Delia, Shpëtim Brika, Besurim Xhepa.

Gjate kohës që ka qëndruar e hapur shkolla e mesme, drejtoria e saj mbulonte dhe arsimin 8/vjeçar, klasa e parë deri tek e teta të fshatit Ceren, si dhe kishte kopsht fëmijësh, tokë dhe bagëti të imëta. Në arsimin 8/vjeçar kishte 210 nxënës. Fëmijët merrnin mësim dhe edukim në institucionet shtetërore për 15 vjet rresht. 8 vjet i detyrueshëm, 7 vjet me dëshirë, 3 në kopsht dhe 4 në shkollë të mesme.

Në vitin 2002 shkolla 8/vjeçare Ceren kalon në Radomirë. Disa nga drejtorët e shkollës Ploshtan kanë qenë:

- Xhemal Cala, Beqir Shehu, Jahe Delia, Nezim Deda, Abaz Daci, Sulejman Istrefi (dy herë), Rasim Deda, Rushin Mena, Isa Lita, Shaqir Kovaci, Shpëtim Brika.

Në shkollën 8/vjeçare Radomirë kanë qenë drejtorë: Xhemal Domi dy herë për 15 vjet rresht, Beqir Shehu, Bajram Ndreu, Miftar Halili, Shazivar Koka, Rrahman Gjoka, Rasim Deda (9 vjet), Fidane Kadiu.

Në shkollën 8/vjeçare Ceren kanë qenë drejtor: Iljaz Palushi, Shazivar Koka, Shpëtim Brika dhe Bashkim Ahmati.

Kanë dalë në pension këta mësues: Maliq Lika, Xhemal Domi, Xhemal Cala, Sulejman Istrefi, Rifat Selmani, Eshref Perzhilla, Shaqir Kovaçi.

Kalaja e Dodës ka njerëz arsimdashës. Nga kjo zonë kanë mbaruar arsimin e lartë mbi 100 veta.

Gjurmëve të dijes

Nga **BASHKIM FRANGU**, **Burrel**

Qenka e çuditshme jeta. Sa më shumë vite kalojnë, aq më shumë u shtuaka malli dhe nostalgjia për të kaluarën, për vitet e fëmijërisë, sidomos ata të shkollës. Të tilla ndjenja më ngjallen sot, teksa çoj mendjen shumë kohë më parë, në vitin 1956, atëherë kur ishim maturantë. Është pikërisht Peshkopia, qyteti i bukur mikpritës e bujar, që na e dha këtë kënaqësi, maturantë në shkollën e mesme pedagogjike, e cila hapi dyert në vitin 1948. Atëherë vendi kishte nevojë shumë për mësues, pasi lufta kundër analfabetizmit ishte duke u ngjitur në kulm, dhe pse pa kuadro të përgatitur mirë, por që kishin një vullnet të madh. Pikërisht në atë kohë për zonat e veriut u mendua që shkolla për mësues të hapej në Peshkopi. I pari i ri matjan që shkeli dyert e saj ishte Nazmi Tafaj, i cili pas mbarimit të mësimeve, iu përkushtua arsimit në Mat. Më 1952 edhe unë, së bashku me Isuf Nelin e Osman Pëllumbin, vazhdova atë shkollë. Në vit të dytë gjetëm Bajram Çupin, Gazmend Kurtin dhe Ahmet Tafajn, ndërsa në të tretin Ali Zajmin. Pra, u bëmë tetë djem nga Mati. Që në ditët e para ndjemë ngrohtësinë, dashurinë dhe respektin e shokëve, mësuesve e kujdestarit të konviktit. U përfshimë shpejt në jetën plot vrull të shkollës, klasës, por dhe të qytetit të Peshkopisë. Ishim shumë të motivuar për përvetësimin e dijeve me nivel të lartë, siç ishin kërkesat e kohës. Tani, 54 vjet më vonë, kujtoj momente nga ditët e para. Kujtoj mësuesin e nderuar Jorgji Sinjari, bashkëstudent e shok i ngushtë i prof. dr. Aleks Budës, i cili më ngriti në mësim që në ditët e para. Dhe pse isha ndër më të vegjëlit e klasës, ai u kënaq për përgjigjet e mia të sakta. Gjithashtu kujtoj mësuesen Julia Levani nga Elbasani, ish-mësuese e shkrimtarit të shquar Ismail Kadare. Mbresa na la që në ditët e para drejtori i shkollës, prof. dr. Shefik Osmani, për nivelin e lartë të mësimdhënies, elokuencën dhe komunikimin me nxënës, kuadro etj. Dhe pse pesha e viteve bën të sajën, kujtesa qëndron. Nuk mund të harroj nivelin e lartë profesional dhe mënyrën e komunikimit me nxënës të mësuesit të talentuar të fizikës e matematikës, Kleanthi Qendro, që më vonë u transferua në ish-Institutin e Lartë Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani". Kujtoj mësuesin e edukimit fizik, Ismet Bellova, që më vonë do ta njihte tërë Shqipëria si specialist sporti dhe komentator i ndeshjeve të futbollit, mësuesin e gjuhës ruse, Ali Demeti, i cili me aq pasion e kompetencë jepte lëndën e vështirë. Me nostalgji kujtoj dhe sot, disa vite pas vdekjes, mësuesin e muzikës, Munir Shehu, që aq shumë dha për muzikën e folklorin, jo vetëm në Peshkopi, por dhe në Mat, duke fituar respektin dhe vlerësimin e tërë matjanëve. Të vlerësuar e të respektuar do të mbeten për ne ish-pedagogjikasit dhe qytetarët e Peshkopisë mësuesit pasionantë e të aftë Llazar Mbreshtanaku e Kadri Shupheja, që na dhanë lëndët kimi-biologji. Kontribute kanë piktori i talentuar Andon Lakuriqi, mësuesit Fadil Duhanxhiu, Ismail Erebara etj. Në vitin e tretë e të katërt të mësimeve erdhën dy mësues të talentuar, Shefki Hafizi e Perihan Dizdari. Astrit Hoxha nga Peshkopia do të zëvendësonte drejtorin e shkollës, Shefki Osmani.

Vitet rrodhën njeri pas tjetrit, me rezultate të larta, gjithnjë në ngjitje dhe shkolla jonë pedagogjike do të zinte vende nderi në shkallë kombëtare. Qyteti krenohej dhe gjallërohej nga aktivitetet kulturore-artistike dhe sportive. Në fundjava ndjehej atmosfera festive me koncerte, festivale e ndeshje sportive. Nuk mund të harrojmë studimet që bënim gjatë provimeve në natyrën e fshatrave të bukur pranë qytetit, sidomos në kohën e qershive në Dohoshisht, Pollozhan, Rrashnapojë, Tomin, Pilaf etj, ku ndjenim mikpritjen dhe ngrohtësinë e bujqëve të talentuar e duarartë dibranë. Na dukej se ditët, javët, muajt e vitet, me vullnetin e pasionin që ne pedagogjikasit kishim për mësim e dije, kalonin si pa u ndjerë. Gara se kush mësonte më shumë dhe kush dilte në pararojë, shtohej. Në klasën tonë 17 nxënës ishin nga Dibra, 14 nga Kukësi dhe të tjerët nga Tropoja e Mati. Mirditorë klasa jonë nuk kishte. Nuk harrohen disa nga shokët që aq shumë i deshëm e na deshën, të cilët fatkeqësisht nuk jetojnë më. Ata janë Basri Spahiu, Halil Visha nga Kukësi, Myfit Trepça, Subi Abazi, Sejfulla Shehu nga Peshkopia, Ibrahim Shabani nga Tropoja, Osman Pëllumbi nga Burreli. Ndjej keqardhje pse sot me një pjesë nuk kemi komunikim.

Duke hedhur shikimin ndër vite sjell ndër mend ish-nxënësin e talentuar, Agim Bardulla, pedogog matematike në Universitetin e Tiranës, Abdurrahman Tota, Dalip Tota e Hysen S. Shehu nga Kukësi. Me respekt kujtoj shokun e ngushtë Xhelil Gjoni, që do të ngjitej në maja të larta të qeverisjes së kohës, Maxhun Pekën, që bëri karrierë dhe prej 45 vjetësh është i nderuar e i njohur në diplomaci. I nderuar dhe i respektuar mbetet Sefedin Juniku nga qyteti i Peshkopisë, portieri i talentuar i shkollës dhe i qytetit, të cilin shpata e diktaturës e goditi ashpër dhe padrejtësisht. Me mallëngjim kujtoj Hysen Haki Shehun nga Peshkopia dhe Hysen Sulejman Shehun nga Kukësi, poet lirik i shkollës, bashkë me Gjergj Ndoun, i cili humbi jetën aksidentalisht pa mbaruar vitin e katërt.

40 nxënës ishim kur morëm maturën. Secili mbetet në mendjen dhe zemrën time. Nuk mund të harrohen Mehmet Rama nga Margegaj i Tropojës, Mehmet e Zaim Hoxha nga Pakishti i Kukësit, Xhemal Derri nga Kruma, Hilmi Palushi - Kukës, shoku i bangës, Nazmi Plaku nga Peladhia e Bulqizës, Nezir Jata - Kukës, Qerim Lamaj nga Kalisi. Shokë të tjerë të maturës 1956 janë Halit Dibra, Xhevdet Xholi, Hasan Poga, Genc Bardulla, Pëllumb Nurçe, Rasim Çiku etj. Nuk harrohen dhe ata shokë, që ishin më të rritur, Shemsi Manjani, sportistët e mëvonshëm Riza e Lutfi Manjani etj.

Nga ajo shkollë Mati ndër vite ka nxjerrë mësues të talentuar, ndër të cilët përmend Nazmi Tafaj, Esat Sula, diplomati i njohur Abdi Baleta, Xhemal Murati, Fran Lena, Muharrem Dezhgiu, prof. dr. Shaban Çollaku etj. Kontributi i ish-pedagogjikasve të Peshkopisë është i madh dhe i pazevendësueshëm. Shumë prej tyre kanë kryer studimet e larta dhe kanë dhënë kontribut të çmuar në arsim si mësues e drejtues. Veçohen Mësuesi i Meritуar Beshir Shira, mësuesi i talentuar Mustafa Salia, Prengë Përshqefa, Haxhi Bodini, Gani Ahmeti, por dhe Ramiz Doçi, Hamdi Ruçi, Nexhmi Çollaku, Qazim Kurti, Sali Likcani, Avni Leka, Qamil Duka, Rexhep Pupla, Fatmir Beta, Rustem Stana, Hazis Ballabani etj.

U bënë 50 vjet, një gjysëm shekulli, qëkur lamë bangat e kësaj shkolle dhe u bashkuam me armatën e madhe të mësuesve. Sa shkolla ndërruam, sa fshatra e zona shkelëm, sa nxënës dora-doras pritëm e përcollëm. Tani në pension na ndizet malli për të gjithë. Ku vallë janë? Të shpërndarë nëpër atdhe, po dhe nëpër rrugët e kurbetit. Dikush ka shkuar në botën e vërtetë, duke lënë gjurmët pas. Eh, jetë! Ndjehesh krenar kur të gjitha forcat i ve në sherbimin e popullit tënd. Presim të takohemi në përvjetorin e 60-të të hapjes së shkollës së mesme pedagogjike të Peshkopisë. Drejtuesit e sotëm të saj shpresojmë të na e krijojnë këtë mundësi.

**Maturant i vitit shkollor 1952 - 1956*

Ndjehesh krenar kur të gjitha forcat i ve në sherbimin e popullit tënd. Presim të takohemi në përvjetorin e 60-të të hapjes së shkollës së mesme pedagogjike të Peshkopisë. Drejtuesit e sotëm të saj shpresojmë të na e krijojnë këtë mundësi.



Në foto: Kolektivi i shkollës pedagogjike "8 Nëntori", Peshkopi, mësues e nxënës, me drejtor Prof. Dr. Shefik Osmani, viti 1954.

MATURA V, 1952-1956

1) Agim Bardulla, Peshkopi
2) Genc Bardulla, Peshkopi
3) Abdurrahman Tota, Kukës
4) Dalip Tota, Kukës
5) Hysen Sulejman Shehu, Kukës
6) Hysen Haki Shehu, Peshkopi
7) Xhelil Gjoni, Peshkopi
8) Halil Visha, Kukës
9) Basri Spahiu, Kukës
10) Sulejman Sinamati, Kukës
11) Subi Abazi, Peshkopi
12) Sejfulla Shehu, Peshkopi
13) Pëllumb Nurçe, Peshkopi
14) Halil Dibra, Peshkopi
15) Sefedin Juniku, Peshkopi
16) Maxhun Peka, Kukës
17) Xhemal Derri, Kukës
18) Ibrahim Shabani, Tropojë
19) Mehmet Rama (Margjeka), Tropojë
20) Hilmi Palushi, Kukës
21) Xhevdet Xholi, Peshkopi
22) Hasan Poga, Peshkopi
23) Rexhep Fetahu, Peshkopi
24) Ahmet Balliu, Peshkopi
25) Nazmi Plaku, Peshkopi
26) Lavdrim Kaba, Peshkopi
27) Rasim Çiku, Peshkopi
28) Bashkim Frangu, Burrel
29) Isuf Neli, Burrel
30) Osman Pëllumbi, Burrel
31) Nezir Jata, Kukës
32) Mehmet Hoxha, Kukës
33) Zaim Hoxha, Kukës
34) Myfit Trepça, Peshkopi
35) Qerim Lamaj, Kukës

LAJMËRIM

Në kujtim të 32 dibranëve të zhdukur në ujërat e Otrantos në natën e 9 marsit 1996, po përgatitet një një libër. Ftojmë të gjithë familjarët, të afërmit dhe të tjerë që kanë dijeni për këtë ngjarje të përcjellin në adresën e gazetës "Rruga e Arbrit", fotografi, shënime për jetën e personave, dokumente, kujtime, etj. Le të jetë ky libër një lapidar për ta.

Adresa: "Botimet "m&b", Rr. "Zenel Baboçi", Pall. "Ferar", Tiranë. (Për gazetën "Rruga e Arbërit") .

E-mail: **rrugaearberit@gmail.com**

Dibër: Gjimnazet, kalueshmëria 70%

Në mbyllje të vitit shkollor 2007-2008 70% e nxënësve që vijojnë shkollat e mesme në rrethin e Dibrës kanë rezultuar kalues, me një notë mesatare 6.5. Kjo shifër, e bërë publike nga Drejtoria Arsimore, konsiderohet ende e ulët në krahasim me nivelin e shkollave dhe rretheve të tjera.

Shkaqet, sipas specialistëve të arsimit, janë tek mospërkushtimi i vetë nxënësve si dhe te mungesat në kuadrin e nevojshëm mësimdhënës. / **M. Lala**

Saga e Kaloshëve është një sagë e ndërprerë dhunshëm nga një kohë arkaike e depresive, duke sjellë me vete pasojat e një keqpërdorimi të rëndë të të vërtetave që lidhen me rolin e Kaloshëve në historinë e Dibrës dhe në atë kombëtare.

Një histori poetike për mbijetesën e genit të lirë

Rreth librit "Qëndresa" të Enver Kaloshit

Nga **Dukagjin HATA**


Historia e kombeve, në thelb, siç thotë Cvajku, nuk është gjë tjetër veçse është historia e familjeve të mëdha, të cilat me kontributet e tyre historike janë kthyer në pika referimi dhe arkitipe të rezistencës ndaj çdo humbjeje kujtese e tjerësimi nacional. Fshirja me gomën e paragjykimit për një gjysëmshekulli e kontributeve dhe vlerave të këtyre familjeve në Shqipëri ishte një nga proceset më të dhimbshme të humbjes së logjikës së fakteve e të vërtetave historike, mohimit të genit të fortë kombëtar që sendërtuan në vizionin historik të vendit të tyre këto familje dhe individët më të shquar të tyre.

Të vërtetat personale e familjare të pinjollëve të familjeve të mëdha, në rrekjen e tyre qëndrestare për t'i mbijetuar zulmës së epërme të tamtameve komuniste, janë një nga hullinjtë që të çojnë tek e vërteta e kyçur në "Kutinë e Pandorës së Kuqe" e këtyre familjeve dhe e atyre shtresave sociale e politike në përgjithësi, që pushtetmbajtësit i etiketuan si "të mundurit", por që në fakt qëndruan në antipod të trumbetimit të "njeriut të ri" shqiptar, hibridit lejfenist, në genin e të cilit u injektua në mënyrë artificiale shthurja morale, hipokrizia dhe dyzimi.

Të gjitha këto të bien ndërmend ndërsa merr në dorë dhe nis shfletimin e librit "Qëndresa" të autorit Enver Kaloshi, një rrëfim i dendur për shpirtin e mbijetesës së njeriut të paragjykuar dhe të derës e genit të paragjykuar.

Saga e Kaloshëve është një sagë e ndërprerë dhunshëm nga një kohë arkaike e depresive, nga "një kohë e sëmurë", siç mund të thoshte Erik From, duke sjellë me vete pasojat e një keqpërdorimi të rëndë të të vërtetave që lidhen me rolin e Kaloshëve në historinë e Dibrës dhe në atë kombëtare. Kulla e Kaloshëve, ku u lindën e u rritën kapedanë e gjeneralë, burra të besës e të dijes, bujarë të lindur e fisnikë të shkallës sipërore, pas ardhjes në pushtet të çlirimtarëve që, duke hedhur valle këndonin një refren diabolik: "Luaje, more luaje këmbën, Dibrës ia q… t'ëmën", u sulmua që nga bedenat me slogane, citate, armë zjarri, rrethim ekonomik, ndjekje e survejime të pinjollëve, burgje politike e vrasje me gjyqe të sajuara ose pa gjyq, ku mjaft nga bijtë e saj mbeten pa një varr ku t'u prehen kockat.

Një nga protagonistët e këtij viktimizimi është dhe autori i këtij libri, Enver Kaloshi, i cili ashtu si Sizifi



me gurin e rëndë të së pamundurës, u rropat në luftë me absurdin, pa pranuar që të bëhet pjesë e mekanizmave të këtij absurdi klithës. Bir i një nëne heroinë që e dashuron lirinë dhe shkollimin e djalit të saj me çdo qelizë të trupit e të shpirtit dhe i një babai - ish oficer i Lartë i Mbretërisë, arratisur maleve pas ardhjes në pushtetet të komunistëve, plagosur e kapur nga forcat e Ndjekjes, dënuar me pesëmbëdhjetë vjet burg politik, me një gjysh të pushkatuar nga falangat e krimit të kuq, Llan Destan Ndregjonin, një burrë i fisëm që më shumë se jetën e tij deshi lirinë e trojeve stërgjyshore, ku u përkundën në djepe druri me ninulla lufte Kastriotët, me një histori brilante të kullës legjendë dhe burrave të saj mitikë, që këndohej netëve në male me lahutë e çifteli, Enver Kaloshi rrëfen me zemër në dorë të vërtetat e një jete që për nga përmasat e dramës dhe aksionit për përftimin e hapësirave të së drejtës, në ato kushte ku e drejta notonte në pelgje iluzionesh dhe deziluzionesh, është e denjë për një skenar filmi hollivudian.

Duke rrëfyer për veten dhe familjen e tij, ai na sjell para syve një copë historie poetike, - deri tani vonë e deformuar nga dogmatizimi – na sjell mesazhin e qëndresës së genit të fortë përballë sfidave të antigenit.

Jeta personale e Enver Kaloshit është një jetë e mbushur me privime, sfida, luftë për të mbijetuar, drama e tragjedi të denja për artin e rrëfimit shekspirian. Dilema "Të rrosh a të mos rrosh" nuk mund t'i shkonte askujt më mirë se këtij Hamleti nga Dibra, që endej fshat më fshat e vis më vis në kërkim të dritës, këtij njeriu të vërtetë që deri në zgrip të ekzistencës kërkon të ruajë virgjinitetin e derës dhe racës fisnike, pa iu nënshtruar makinës diabolike të së keqes sonë kolektive. Autori që është dhe protagonisti i këtij rrëfimi është njësh në kohë dhe hapësirë, identik me

> "Qëndresa" e Enver Kaloshit është një tjetër dëshmi nga koha e sëmurë që lamë pas, dëshmi e triumfit të shpirtit të lirë mbi dogmatizmin dhe idiotësinë, dëshmi e mbijetesës së "gjakut blu" edhe në kushtet e dhunës dhe terrorit sistematik, që vihej nga lëvizje nga "gjaku i shprishur".

veten e tij më të thellë: fëmijë e i ri, në vendlindje ku lindi, u rrit e u shkollua dhe punoi, në rrethin e Krujës ku punoi një jetë, tridhjetë vjet, si mjeshtër ndërtimi e më vonë si drejtor Arsimi e kryetar partie në rreth, si drejtor Arsimi në Ministri, si vizitor në SHBA, Gjermani, Itali, Mal i Zi, Turqi, Kroaci, Kinë etj.

Nje jetë plot tallaze, por pas çdo tallazi ai mbledh forcat për të vazhduar përpara, i frymëzuar nga ai zëri i pavetëdijshëm i genit, që i thotë se lufta është kuptimi i vërtetë i jetës dhe, kur këtë luftë e fiton, jeta bëhet njëqind herë më e bukur dhe kuptimplote. Ikonat e jetës së tij janë nënë Sibeja, babë Mehmeti, të parët e tij qëndrestarë, piketat e të cilëve në historinë e kombit i ndrijnë atij si meteorë në errësirën e frikshme të një kohe të pakohë.

"Jeta ime i ngjet një rruge të gjatë e të vështirë. Një rruge ndërtuar në shkëmb e në gurë. Me të përpjeta e tatëpjeta. Jetë dhe gurë. Jeta në gurë. I fortë si guri. Po edhe guri thyhet. Edhe njeriu si guri". Kështu e nis rrëfimin e tij të shtruar Enver Kaloshi, duke na paraqitur faqe pas faqeje një histori brilante, të shkruar nga një shpirt sa i brishtë e delikat, i ndjeshëm e sugjestionues, aq i fortë e qëndrestar, kuptimi themelor i qenësisë të së cilit është kërkimi dhe zbulimi i vërtetës, edhe kur kur ky zbulim është i dhimbshëm dhe tronditës.

Enver Kaloshi tregon jo sikur i drejtohet një lexuesi, por vetvetes së tij më të thellë, pa zbukuruar asgjë, me një realizëm gri, gati befasues. Ajo çfarë të lë gojëhapur, kur kthen dhe faqene fundit të këtij libri, është sinqeriteti i autorit, mosmarrja prej tij, për asnjë çast, e ndonjë poze prej heroi, (aq në modë në literaturën e memoristikës).

Autori që është dhe heroi i librit vihet në pozita të rënda sociale, i kushtëzohet ekzistenca, i kushtëzohet puna, shkollimi, e ardhmja, e sorollasin tutje tëhu, pa i dhënë mundësinë të shfaqë vlerat e plota të vetvetes, i duket sikur nuk jeton ai por hija e tij që endet fshat më fshat e vis më vis, duke dhënë dije për të tjerët, ndërkohë që për vete është i rrethuar nga survejimi, paragjykimi, përndjekja.

"Qëndresa" është një jetë në sprovë të vazhdueshme, ku rrëfyesi i kësaj historie të trishtë vihet përballë mekanizmave të degradimit moral e përjashtimit social, jo për shkak të dobësive të tij, por për shkak të epërsive morale dhe intelektualitetit. Ishte një kohë që, duke promovuar "njeriun e ri", i cili nuk mendonte me krye të vet, por me urdhër nga lart, e drejtoi tehun e mprehtë të shpatës së luftës së klasave ndaj të gjithë atyre – njerëz të thjeshtë apo intelektualë- që nuk mund të dirigjoheshin në korin e çmendur të brohoritësve të Drakulës, Përbindëshit, që iu premtonte një parajsë të rrethuar me bunkerë dhe tela me gjëmba.

Enver Kaloshi, duke na zbuluar jetën e tij personale dhe të familjes së tij, nënës Sibe që e shihte në dritë të syrit, babait Mehmetit, - ish oficer i lartë i Mbretërisë, arratisur maleve pas hyrjes triumfale në fundnëntor '44 të komunistëve, plagosur nga forcat e Ndjekjes, arrestuar e dënuar me pesëmbëdhjetë vjet burg politik; gjyshit Llan Detsan Ndregjonit, pushkatuar nga falangat e Sigurimit, hijen e kullës së fisme ku u lindën e u rritën burra me zë që u bënë flakadanë të lirisë së Dibrës e të gjithë Shqipërisë, këngët e të cilëve ende këndohet me lahutë e çifteli në odat e këtyre anëve, zbulon gamën e atyre ingranazheve të ndryshkur të dhunës e tjetërsimit të njeriut, zbulon hendekun paradoksal midis dukjes dhe thelbit të gjërave, në një sistem të ngritur mbi hipokrizinë dhe dyzimin.

Duke lexuar këtë libër, lexuesi, jo vetëm që merr informacione interesante për kohën e vënë nën vete nga një klikë e çmendur dallkaukësh dhe kllounësh, xhelatësh dhe duartrokitësish të sëmurë, spiunësh dhe shërbëtorësh të pa-paguar, nëpunësish servilë dhe të pështyrë, jo vetëm kupton falsitetin dhe idiotësinë e dogmave të kohës, por, në antipod, në kampin tjetër, ndjen dhe thellësitë e shpirtit të qëndresës njerëzore, të atyre që nuk u tjetërsuan nga asnjë rrugë kalvari, por mbijetuan për të dëshmuar të vërtetat e varrosura në arkivat e krimit komunist.

"Qëndresa" e Enver Kaloshit është një tjetër dëshmi nga koha e sëmurë që lamë pas, dëshmi e triumfit të shpirtit të lirë mbi dogmatizmin dhe idiotësinë, dëshmi e mbijetesës së "gjakut blu" edhe në kushtet e dhunës dhe terrorit sistematik, që vihej nga lëvizje nga "gjaku i shprishur".

PORTRET

Pak radhë për **Mehdi Lucën**

Në tetor të 2005 po shëtisja me shokun tim Market Gjergji, mësues në pension dhe veteran i LANÇ-it në rrugën e lagjes sonë Laprakë që të çon drejt spitalit ushtarak. Shoku Market m'u drejtue me një pyetje duke qeshur:


-Shoku Nuredin, a dëshiron me të prezantue me një burrë dibran shumë të shquar?

- E kam për nder që të njihem e të rri me burra të Dibrës, sepse ata kanë thesar mendjen e kemi nevojë me mësue e me përfitue nga zgjuarsia e tyre. Drejt nesh erdhi një burrë i lartë, ecte drejt, me një fytyrë të gëzueshme, tërheqëse. U takuem miqësisht me dibranin e mirë, i cili quhej Mehdi Luca. U ulëm e pimë kafe të tre së bashku dhe tash tre vjet e kemi shoqërinë e pastër dhe s'kalojmë tre ditë pa u takue së bashku. Unë ndjej kënaqësi kur rri dhe bisedoj me Mehdiun, pasi jam plotësisht i bindur se i ka të tana cilësitë e një njeriu të shquar. Mendja e tij e hollë di shumë mirë me e ba për veti bashkëbiseduesin. Për Mehdi Lucën më kanë folur me shumë mirënjohje dhe respekt edhe shokët e miqtë e mi Ali Koceku, Rexhep Shahini, Zabit Lleshi e plot të tjerë, por ajo më kryesorja është se respektin Mehdi Luca ua imponon të gjithëve, ashtu si dhe mua me sjelljet dhe virtytet e larta që ka. Gjatë viteve 1934-1939 mbaroi Internatin e "Kastriotit" me nota të mira. Ishin pikërisht vitet kur retë e zeza u endën në qiellin shqiptar e Mehdiu tashmë i pjekur e kuptonte fare mirë se pushtimi fashist ishte në prag të derës. Ndaj do të vinte koha që shumë shpejt Mehdi Luca do të rreshtohej me ato forca që pretendonin se do të çlironin vendin. Shtëpia e Mehdiut ka qenë një nga bazat kryesore të Luftës Nacionalçlirimtare, ka mbështetur lëvizjen, u bë strehë dhe bazë e sigurt për partizanët. Qysh me ngritjen e çetës partizane të Sllovës, Mehdi Luca do të rreshtohej në radhët e saj dhe si djalë i ri dhe i arsimuar Mehdiu zgjidhet sekretar rinie për zonën Reç e Dardhë, detyrë të cilën e kreu me devotshmëri, duke propogandduar me forcë kudo ku shkonte që të shtohen radhët partizane me të rinj dhe të reja. Në shtëpinë e tij qëndruan plot 12 partizanë në dimrin e egër të vitit 1943-1944. Pas çlirimit në 20. 05 1945 mori pjesë në kongresin e 2-të të Rinisë Antifashiste në Tiranë me shokë e shoqe si: Kozma Vjera, Nebi Agolli, Esma Agolli, Sadush Baholli, Arif Nezimi, të cilët shkuan në këmbë nga Peshkopia në Tiranë...

Pas çlirimit shërbeu në Komitetin e Rinisë, në D. P. MB, në Komitetin. Ekz të rrethit Peshkopi si dhe në ndërrmarrje të ndryshme, deri sa doli në pension në 1985. Gjatë jetës në rini është dalluar në sporte të ndryshme, në gara vrapimi, ku në vitin 1948 zuri vendin e dytë në Peshkopi. Për merita lufte dhe pune sot mban 4 (katër) dekorata të larta. Është një veprimtar i shquar për edukimin e brezave me traditat e mira të LANC-it dhe merr pjesë me veteranët e tjerë në raste gëzimi dhe për ngushëllim kudo jo vetëm në Laprakë, por dhe jashtë saj.

NUREDIN SADIK LUSHAJ

BOTIME TË AUTORËVE DIBRANË



"Kanada" - me autorë Shpëtim Camin dhe Kastriot Frashërin

"Nëpërmjet këtij libri synojmë të paraqesim një këndvështrim rreth Kanadasë në hapsirat mbarëshqiptare. Ne jemi përpjekur që të prezantojmë jo vetëm gjeografinë, kulturën, turizmin, arsimin, komunitetin shqiptar dhe qeverisjen në Kanada, por edhe informacione dhe këshilla se si mund të jetosh, emigrosh, punosh e studiosh në Kanada"

PREZANTIMI I LIBRIT DO TË BËHET NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR, NË DITËN E KANADASË, MË 1 KORRIK 2008, ORA 19.00. MIQTË DHE DASHAMIRËSIT E AUTORËVE MUND TË MARRIN PJESË. HYRJA ËSHTË E LIRË.



Prof. Dr. Andrea Shundi Agr. Arif Daçi.


"Fjalor shtjellues: Vreshtaria dhe verëtaria". ISBN 9993-912-2-4. Cmimi: 800 lekë

botime

"Tregime të rralla popullore", "Ese filozofike me motive popullore", "Tregime mitologjike ", tre libra brenda një titulli risjellin Xhafer Martinin me një botim të ri dhe dinjitoz, i vlefshëm për të qënë pasuri e çdo biblioteke personale

"Fjala priu...", një libër i rrallë

T'i qasesh fjalës së populli është përgjegjësi e madhe, pavarësisht nga mënyra dhe qëllimi. Populli e vlerëson shumë fjalën. Ajo ka përparësi në lidhje me veprimin, sepse i paraprin atij. Populli ka një thënie: "Fjala priu, forca griu" e ngjashme pak a shumë me thënien biblike: "E para është fjala"



Kopertina e librit të Xhafer Martinit, "Fjala priu..."

Shkrimtari Xhafer Martini del para lexuesve me një botim të ri, me një libër disi të veçantë dhe të rrallë në llojin e tij. Në këtë përmbledhje përfshihen tre libra:

1-Tregime të rralla popullore

2-Ese filozofike me motive popullore

3-Tregime mitologjike

Që të tre këto libra edhe pse janë botuar në një përmbledhje të përbashkët kanë dhe të veçantat e tyre. E përbashkëta qëndron në faktin se këto libra, qoftë studime, qoftë krijimtari, mbështeten në kulturën e popullit, në folklor dhe në mitet: tregojnë mënyrën e qasjes së autorit ndaj kësaj kulture. E veçanta qëndron në faktin se prezantojnë anë të ndryshme të kaluarës popullore. Në "Tregime të rralla popullore" janë përfshirë një tufë tregimesh që përbëjnë shtresën më të hershme të folklorit gojor, ku "bashkëjetojnë" në harmoni të plotë shpirti dhe trupi, bota e këtushme me botën e përtejme, realiteti dhe fantazia, perceptimet konkrete dhe asociacionet. Problematika e këtyre tregimeve është shumë e pasur. Trajtohen probleme morale, filozofike, ekonomike, shoqërore, familjare, estetike, fetare, mistike, etj. Në këto tregime kemi një galeri të pafundme tipash dhe karakteresh; në to ndeshën i miri e i keqi, i mençuri e budallai, toleranti e intoleranti, i drejti e i padrejti, i ndershmi e batakçiu, pajtimtari dhe shernxitësi, shpresëdhënësi e nihilisti, bujari e kopraci, fisniku e vulgari, i përkori e grykësi, trimi e frikacaku etj., etj. Subjektet janë të popullit, por të plazmuara në formën më të përshtatëshme, duke mos tjetërsuar mesazhet, rrethanat, personazhet e situatat. T'i qasesh fjalës së popullit është përgjegjësi e madhe, pavarësisht nga mënyra dhe qëllimi. Populli e vlerëson shumë fjalën. Ajo ka përparësi në lidhje me veprimin, sepse i paraprin atij. Populli ka një thënie: "Fjala priu, forca griu" e ngjashme pak a shumë me thënien biblike: "E para është fjala" Populli këto tregime "i thotë me dy fjalë", se për të ka rëndësi përcjellja e mesazhit. Por për një shkrimtar kjo nuk duhet të jetë e mjaftueshme, pasi çdo mesazh e ide duhet të transmetohet me një formë sa më të përkryer artistike. Marciali poet latin, shprehej për poezitë e veta të recituara: "O Fidentinë, ato vjersha që do t'i recitosh, janë të miat, por kur i reciton ato s'janë më të miat".Kur kjo ndodh me recitimin, çfarë mund të ndodh me krijimtarinë gojore të popullit kur e mbledh,për të parën herë një shkrimtar? Sigurisht ndodh një transformim më i madh se sa recitimi i një poezie. Këto tregime në të kaluarën janë lënë jashtë vëmendjes së mbledhësve të folklorit gojor, për arsye se përbënin atë shtresë që nuk përputhej me ideologjinë nga e cila udhëhiqej jeta jonë. Atëherë edhe në mbledhjen e publikimin e folklorit mbahej parasysh porosia e Leninit "për dy kulturat", njëra e popullit të thjeshtë dhe tjetra e klasave sunduese. Ndonjë prej këtyre tregimeve është përfshirë edhe në librin "Ese filozofike me motive popullore", por me qëllim ilustrimi, sa për të përcjellë mesazhin. Vetëm këtu paraqiten të plotë dhe me pretendime artistike. Në "Ese filozofike me motive popullore" jepen disa aspekte të filozofisë së popullit, ku pasqyrohet qëndrimi i tij për dukuri nga më të debatueshmet si: Liria, Mendja, Fati, Vdekja, Musa, Gjeniu, E drejta dhe E vërteta etj. Jepen shembuj konkret nga jeta. Populli nuk i përmbahet një shkolle të caktuar filozofike, ai ka një filozofi të vetën, që buron nga përvoja e gjatë jetësore. Megjithëse libri është shkencor, i mbështetur në burime të shumta, ndryshon nga librat e filozofëve, mbasi problemet dhe dukuritë trajtohen me shembuj nga jeta e personaliteteve të shquara etj. Është e dallueshme mënyra se si merret shkrimtari me këto probleme, nga mënyra se si merret filozofi. Filozofia e popullit ka pika takimi dhe ndarjeje me shkolla të caktuara filozofike dhe këto gjejnë pasqyrimin e vetë në libër. Filozofia e popullit nuk është e ngrirë, ajo ka evoluar nga koha në kohë, duke nxjerrë mësimet e mëvonshme nga proceset historike të çdo periudhe të jetës së popullit. Në filozofinë e popullit zotëron dualizmi, ku përqasen të kundërtat që pranohen të dyja. Populli të kundërtat nuk i shikon në kontradiktë, por si plotësuese të njëra tjetrës. Kjo është thelbësore në mendimin filozofik të tij. Lexuesi do ta shikojë në ç'rast ndodh kjo dhe sa mbushamendës është qëndrimi i popullit. Populli u jep rëndësi të jashtëzakonshme rrethanave, kushteve historike-shoqërore për të përcaktuar dukuritë e ndryshme filozofike. Besojmë që libri do të lexohet me kënaqësi mbasi filozofia e popullit, megjithëse e thellë, është shumë e thjeshtë për mënyrën dhe mjetet e paraqitjes së saj. Në qendër të librit "Tregime mitologjike" janë qeniet mitologjike si Kuçedra, Dragoi, Xhindet, Lugati, Orët etj. Nuk jepen nëpërmjet tregimeve me subjekte interesante dhe dramatike duke e çuar lexuesin në mjedise sa realiste aq edhe fantazmagorike. Edhe në këto tregime dallohet këndi i shikimit të shkrimtarit nga ai i studiuesit të mitologjisë. Studimi i kësaj fushe i paraqet qeniet mitologjike me ato mundësi dhe mjete që ka në përdorim shkenca, kurse shkrimtari bën që bëmat dhe veprimet e tyre të procedojnë në mënyrë të natyrshme, saqë ne na duket se kemi të bëjmë me personazhe të zakonshëm letrarë. Meqë mitologjia u përket shtresave shumë të hershme të kulturës popullore, është plotësisht e pranueshme që këto qenie mitologjike, ashtu si kanë përfytyruar njerëzit e asaj kohe, të mos kenë barriera dhe kufij për ekzistencën dhe veprimet e tyre, prandaj është fare e natyrshme që të zotërojë çudibërësja dhe e mrekullueshmja si në përrallat fantastike. Por tregimet mitologjike dallohen nga këto lloj përrallash se, nëse pas personazheve të këtyre të fundit shihen veprimet dhe qëndrimet e njerëzve, në tregimet mitologjike jepen raportet e qenieve mitologjike me njerëzit. Ka ndonjë tregim që në pamjen e parë duket si realist, për shembull Nënë Pashja. Po ajo është një qenie mitologjike, pasi qumështi i saj është çudibërës, ai i shpëton fëmijët nga vdekja e sigurt. Letërsia nuk merret me anën e jashtme të qenieve mitologjike, por me thelbin e natyrës së tyre; për letërsinë nuk ka barriera dhe kufij të parakohshëm. Është e kuptueshme që secili nga këto libra mund të botohej më vete. Por botohen bashkë jo vetëm se kanë një tematikë dhe problematikë të përafërt, por se vlerat e veçanta të secilit prej tyre, plotësohen nga vlerat e përbashkëta. Qëllimi i autorit është të paraqesë një kompleks kulturor, një sistem vlerash, i cili nuk mund të përfitohet nga bashkimi mekanik i disa prej tyre, por vetëm nga vlera të integrueshme, që funksionojnë më mirë së bashku se sa vetëm.

Xhafer Martini

Në sa breza del harami

Një burrë po udhëtonte në një krahinë të largët. Ishte dimër i madh. Perëndimi i diellit e zuri në rrugë. Donte edhe shumë orë me kapun shtëpinë ku do të shkonte. Duhej gjetur një vend me shpëtue kokën. Në të dyja anët e rrugës nuk kishte gjë tjetër përveç një pylli të dendur. "Duhet të nxitoj që të mos më zërë nata në pyll"- tha me vete udhëtari. Po të mos futej në ndonjë katund me dritë, ishte i humbur. Ec e ec dhe ja ku dalloi shtëpitë e para të një katundi. Nuk mendoi gjatë, por iu afrua një burri, i cili po vinte rrugës me një mushkë të ngarkuar me dru. E përshëndeti dhe i tha:

- Jam shtegtar i largët e kam mbetur jashtë. A thua nuk ju ngushtoj, po të rri sonte tek ju?

- Jo bre bashi i mikut. Po prit pak sa të shkarkoj mushkën dhe futemi brenda, - i tha zoti i shtëpisë me ashk zemre.

Pastaj ai shkarkoi mushkën, e futi në ahër dhe i vuri torbën me elb. Gjatë kësaj kohe shtegtari i mbajti sytë në mushkë. Ajo i pëlqeu shumë. Kur hynë brenda, zjarri bubullonte, por zoti i shtëpisë lëshoi në të edhe një krah me dru të trasha dushku. Udhëtari u ngroh, u tha se qe lagur i tëri, nga koka tek këmbët, dhe ndjeu njëfarë mirënjohje për këtë njeri të mirë që e priti me aq dëlirësi e bujari. Por mirënjohja e tij ishte si një vetëtimë, pasi në kokë kishte mendime të tjera e në zemër dëshira të tjera. Darka u shtrua me ato që kishte falë Zoti; biseda qe e ëmbël se zoti i shtëpisë gëzohej shumë kur i shkonin miq, qoftë edhe të panjohur si ai i asaj nate. Ia a hapte shtegun mikut për muhabet, por ai i asaj nate kishte qëlluar njeri i heshtur. Më mirë të themi u tregua i rezervuar,madje i pasinqertë se nuk i tha as emrin e vërtetë. Pse e bëri këtë, një Zot e di! Por zoti i shtëpisë i besoi, se ishte njeri pa të keq. Në zemrën e tij kurrë nuk bënte fole dyshimi. Mbas darke, miku, duke i hedhur një shikim të picërrt, e pyeti të zotin e shtëpisë:

-Mos di në sa breza del harami?

-Harami del në brezin e shtatë. Ranë me fjetë në odën e burrave, si është zakon ndër malësi. Gjithashtu është zakon që zoti i shtëpisë të flejë në një odë me mikun, me ju ndodhë atij për çdo nevojë. Të zotin e shtëpisë e zuri gjumi sa vuri kokën në jastëk, kurse miku, megjithëse ishte i lodhur nga rruga e gjatë, kthehej e rrotullohej, përpëlitej si zorra në prush.Në odë ishte ngrohtë, mbyllja e kapakëve të dritareve bëhej mjaft puthishëm, zjarri në vatër nuk shuhej, por atij i kishte hyrë akullima në zemër dhe i dukej se ende po ecte në muzgun e përborëtuar të atij dimri të ashpër. Mendja i rrinte tek mushka, që ishte e re dhe e bukur."Sikur të ngrihem natën e t'ja vjedh", tha me vete. E kishte jeratisur Zoti dorë të keqe, që nuk rrinte dot pa vjedhë. Ishte siguruar se harami dilte në brezin e shtatë."Ohu",-tha me vete."Mua nuk do më zërë, as djalin tim jo, as djalin e djalit nuk do ta zërë...pse të mos e vjedh?!"I zoti i shtëpisë ishte në gjumin më të rëndë, kur miku u ngrit me kujdes, u vesh pa zhurmë dhe doli jashtë, ku i ftohti që të priste si brisk, ia rrufiti faqet. Shkoi në ahër. Kur i zoti i shtëpisë u ngrit në mëngjes, mikun nuk e pa në shtrojen e vet. "Ku shkoi ky?"-pyeti veten, por dyshime nuk kishte në shpirtin e tij të pastër. Mbase ka dashur të ik herët pa më nxjerrë gjumin, mendoi.Por e kuptoi se kjo nuk arsye për të ikur pa u përshëndetur me zotin e shtëpisë. Shtyri derën ku flinte gruaja me fëmijët.

-Oj grua, më ka humbur miku.

-Po ç'të të bëj unë, or burrë?! Prandaj zoti i shtëpisë fle në një odë me mikun me e sigurue mos me i ndodhë e keqja, por edhe mos me ba keq.Gruaja kishte të drejtë. Burri ziente nga inati, por nuk kishte ç'të bënte. Doli në oborr e hodhi sytë nga udha e madhe e katundit. Hiç, asgjë e gjallë. Hyri në ahër për të parë mushkën. Do të shkonte për dru herët dhe do t'i vinte qysh tani torbën me elb. Vuri duart kokës dhe mbeti pa mend kur pa mikun të shtrirë sa gjatë gjerë në mes të ahurit. Ai rënkonte thellë. Zoti i shtëpisë iu afrua dhe pa se nga balli i zbriste teposhtë, drejt gojës, një rrëke gjaku, që pastaj rrëzohej faqes së majtë e binte në pleh. Miku ishte gjallë por në grahmat e fundit.

-Ç'të pruri këtu, bre mik?

-Më more në qafë,- mezi mundi t'i thoshte ai.

-Po pse të mora në qafë, or mik?Pse të prita me bujari dhe me ashkë zemre, pse të nderova dhe nuk të lashë jashtë të të hanin ujqit? Pse të besova si vëllai – vëllait?.Për këto të mora në qafë?!

-Më the që harami del në brezin e shtatë, kjo më bëri ta vjedh mushkën. Po ajo më vrau. Harami më doli në çast...

-As ato fjalë nuk i ke pas me hile, lum miku. Po ty të ka zënë harami i të parëve të tu që kanë bërë si ti...

*Marrë nga libri "**Fjala priu...**"*

Persiatjet e kalvarit të vuajtjeve të gati një shekulli histori janë ngulitur thellë në rrudhat e lëkurës të ballit, të cilat në pamje të parë në miniaturë paraqisnin një tkurje malore apokaliptike.



Mirto Qormemeti, robi i fundit i Luftës së Dytë Botërore

Në foto: Mirtozan Qormemetit

Shënimet tona nuk kanë të ndalur ata do ti mbeten historisë. Qëllimi i këtij shkrimi, me rastin e trevjetorit të vdekjes së Mirto Qormemetit, ritushon që përmes robit të fundit të Luftës së Dytë Botërore të prezantohet pjesërisht dhimbja dhe vuajtja e popullit të këtij nënqielli.

Nga **ATLI DEMA**

Imazhi mbresës i një jete, që shtreson materiale të mbledhura vuajtjesh si rezultat granitesh të pashmangshme, ngjyrat e jetës së Mirtozan Qormemetit i cili, shkruante dhe lexonte shqip, sërbisht, gjermanisht dhe arabisht, kanë bashkëjetuar me dhimbën e kohës së kombit që i takoi. Atëherë tek ai, persiatjet e kalvarit të vuajtjeve të gati një shekulli histori janë ngulitur thellë në rrudhat e lëkurës të ballit, të cilat në pamje të parë në miniaturë paraqisnin një tkurje malore apokaliptike.

Edhe pse në fëmijërinë e hershme mbeti pa prindër, pas kthimit nga Tirana 1916, vendoset te daja i tij në fshatin Ame, kurse në Dibër u kthye më 1948.

Të shkruash për të s'është e lehtë, sepse s'di ç'të kapësh më parë: fisnikërinë, trimërinë, talentin, këmbënguljen, vullnetin apo dashurinë për kombin.

"Gjatë viteve 1918-1941, Dibra nuk kish shkolla shqip, prandaj mësuesit u shpërngulën në Shqipëri ku punonin në gati gjithë Shqipërinë si Said Najdeni, Haki Sharofi, Vebi Agolli, Haki Stërmilli etj... Ata që mbetën në Dibër punonin punë të ndryshme. Një prej tyre ishte edhe Riza Lata nga fshati Ame, që punonte hoxhë fshati dhe na mësonte mësim fetar. Por në shtëpinë e tij mbas orëve të arabishtes, na mësonte shkronjat shqip dhe vjershat e Naimit, Çajupit", - *kujtonte në një frymë rrëfimin e jetës zoti Mirtozan, duke u thelluar në detajet e vuajtjeve. Kur vërente se ne, rrëfimin e ndiqnim me kureshtje, vijon:*

"Më 1935 shkova ushtar në Karlovë të Kroacisë, por shumë shpejt u sëmura nga një sëmundje ngjitëse, ata pas dy muaj më lëshuan në shtëpi në rehabilitim. Në ushtri më thirën prapë në fund të vitit 1938. Edhe pak ditë duhej që të përfundoja afatin ushtarak. Filluan luftërat nëpër Europë kështu që gjatë bombardimit të Beogradit më 6 prill 1941 isha në Petrovaredin (Zrenjanin) deri më 5 maj 1941. Njësiti jonë endeshte rreth Beogradit. Atëherë komanda na la të lirë, ata që mundën të shkojnë në shtëpi-shkuan, mirëpo në atë kohë gjermanët e kishin pushtuar vendin tonë dhe nga jugu i afroheshin Beogradit, kështu që ishte e pamundur të largohemi nga komanda dhe më 5 maj 1941 në Mitrovicë të stremit u dorëzua komplet njësiti jonë (IV Kraleski Puk).

Gjermanët na ngarkuan në kamionë dhe na nxorën diku në Vojvodinë ku i mblodhën të gjithë robërit e rrethit të Beogradit, afër 200 mijë robër. Për dy javë na sistemuan në Gjermani sipas profesionit, fesë, kombit, njohurive të përgjithshme dhe gjendjes psiko-fizike. Mua më sistemuan në një fabrikë qumështi në qytetin Krefeld afër Düsseldorfit.

Kësaj periudhe të erët iu shtua edhe periudha pas luftës së dytë ku intelegjenca u shua në forma të ndryshme. Fshatrat e brezit kufitar u internuan në Maqedoninë lindore, një pjesë u burgosën dhe me të dhjetëra të tjerë u vranë pa proçese gyqësore. Në fshatin tim u vranë tre fshatarë të pafajshëm nga policia kufitare dhe shërbimet e fshehta të UDB - së "gabimisht". Dhe në çdo fshat tjetër nga dy e nga tre. Familjet që nuk u internuan u burgosën, burrat të cilët nga presionet psiqike (në burg) dhe kërcënimet për zhdukjen e familjeve u detyruan me dashje dhe padashje të bashkëpunojnë me sistemin, një pjesë e mirë e të cilëve me kalimin e kohës edhe u hyri në qejf bashkëpunimi. Me hapjen e kufirit shtetëror ishin të maltretuarit që të parët u shpërngulën në Amerikë dhe Europë. Kështu që sot janë boshatisur të gjithë fshatrat kufitare si: Spas, Ame, Krifcë, Banisht, Shullan, Jazulli, Kojnarë, Bomovë, Shushicë, Tarranik etj... Sot nga këto fshatra kanë mbetur me qindra tregime për proçeset gjyqësore të montuara.

Pra puna është mbi të gjitha... Jeta është komplekse dhe na mundojnë ligjet e saja. Unë shpesh dëshiroj të arrij më shumë se e konceptoj jetën por esapet s'më dalin dot. Sepse në të kam shumë episode të cilat kanë diç të veçantë në rrugë, familje dhe punë. Sot kur mundohem të evokoj kujtime vërrej se jeta më është ngatëruar, dhe më duket e gjatë sa tre shekuj, sepse në këto vende ka patur luftëra të vazhdushme por edhe gjatë kohës së paqës shqiptarët kanë qenë në luftë me sistemin komunist dhe organet e sigurimit. Ky popull gjithë jetën është terorizuar nga pushtete të ndryshme.

Më 1948, kur filluan represionet ndaj fshatarëve kufitar e pash të udhës të shpërngulem në Dibër në trojet ku kisha lindur shton Mirtoja. Sado kudo në qytet e kishin më të vështirë të thurnim përralla me agjitatorët nga Shqipëria.

Të gjithë ligjet kanë pasur anekse diskriminuese për shqiptarët, por ndalimi i shkollimit në gjuhën amtare në mbretërinë jugosllave dhe kufizimi i natalitetit në vitet 1980 kanë qenë kulminacion i të gjithëve dhe gjenocid i pastër. Njeriu që shifrat i hedh si patare, nënvizon se mbi 80% të shqiptarëve të dënuar e din përmendsh përmbajtjen e ligjit 33, alineja 4 dhe 7, vepra kundër popullit dhe shtetit. Bullgarët në luftën e parë kanë qenë afër dy vjet,. Unë kam qenë i vogël dhe mbaj mend pak elemente, por si fëmijë kam dëgjuar shumë ndodhi nga më të moshuarit. Ushtria bullgare 1915-1917 nuk ka pasur furnizim të rregullt, por ka grabitur popullatën sa që nuk u ka lënë edhe ushqim për mbijetesë. Në kohën e okupimit bullgar nga uria njerëzit kanë vdekur nëpër rrugë. Kështu që sëmundjet kanë bërë kërdinë. Në vitin 1916 është përhapë tifusi. Nuk e di saktë, por çdo shtëpi ka pasur të vdekur nga tifoja. Unë mbaj mend kur disa njerëz me fytyra të lidhura dhe dorëza të gjata e morrën kufomën e babait dhe e vorrosën në varr masiv të lyër me gëlqere. Ndërsa ne shkuam në fshat te daja i cili gjithashtu gjindej i arratisur në mal. Mbaj mend edhe nëna na jepte disa toptha të zinj me hitha dhe pak miell elbi.

Ngase babai punonte si telegrafist në postë deri atëherë kishim gjëndje mesatarisht të mirë ekonomike. Këtë zanat e kishte marrë në Kairo në postën e oborit mbretëror për shkak se gjyshi kishte shërbyer për shumë vite deri në penzion në oborin mbretëror të Kairos. Në fshat kishim vetëm një dajë ngase dy të tjerët ishin vrarë në luftën e Vllajnicës (Gostivar). Daja në vitet 1918 u vra me sërbët dhe francezët ndërmjet Dibrës dhe Strugës. Kështu që mbetëm edhe në fshat jetim për rend të dytë. Në kujdesin e gjyshes dhe nënës të cilat na rritën duke shitur nga një copë tokë deri sa u mëkëmbën.

Bullgarët në Dibër s'kanë qenë të sigurt sepse grykën e Radikës dhe grykën e Drinit të zi shpeshherë e kanë kontrolluar forcat e Jusuf Ndreut - Xhelilit dhe Dan Camit e Hoxhë Muglicës. Kështu që bullgarët kanë krijuar të ashtuquajturën qeverinë e përkohshme të Dibrës me një komision të përzier, shqiptarë, sllav, turq dhe torbesh. Megjithatë para se të hynë forcat sërbo-franceze kanë lidhur për t'i pushkatuar 200 burra te zgjedhur të Dibrës. Por mekanizmin që e kanë pasur frikë, funksionoi. Jusuf Xhelili me Pop Maqellarën u dërgoi fjalë se nuk do të lëshon asnjë bullgar të gjallë nga gryka e Radikës dhe Drinit të zi në rast se ekzekutohen dibranët. Ndërsa periudhën e administrimit italian, Dibra e kujton me mall dhe nostalgji.

Dibra e Madhe siç i themi regjionit të Dibrës jashtë kufijve shtetëror, në periudhën e Italisë për radhë të parë në histori ka përjetuar një lulëzim kulturor, ekonomik dhe politik. Vështirë se do të këmi ndonjëherë ashtu lulëzimi. Edhe pse ka qenë periudhë lufte dhe mjaft e shkurtër ajo ka lënë kujtime të shumta në popull."

Plaku 93 vjeçar pasi shtërngon gishtat fuqishëm herë të njërës e herë të dorës tjetër sërish hudhet me bisedë në kujtimet e tij gjatë kohës kur ishte rob lufte.

"Pas orarit të punës flenim në baraka ushtarake nën mbikëqyrjen e disa pleqve rezervistë. Punonim 8 orë, ndërsa pasdite (në fillim me mbikëqyrje) shëtisnim nëpër qytet, merreshim me sport, mësonim gjermanisht nga fletushka e revista speciale për ne. Ushqimi në baraka vinte nga kuzhina ushtarake dhe nuk kishte ndryshim nga ushqimi i rekrutëve gjerman. Ndërsa ne, muslimanëve, na jepnin ushqim të veçantë dhe nuk na pengonin për namaz dhe Ramazan. Pas gjashtë muajsh na dhanë nga një kartolinë që të paraqitemi në shtëpi.

Pas një viti më transferuan në Düsseldorf në një repart të "Krup–it", ku punoja në kaldajat qëndrore. Në vitin 1943 na dhanë të drejtë të pranojmë shtetësinë gjermane dhe të kalojmë në qytetarë të lirë gjerman. Dhe me këtë rast një numër i madh sllovenësh, kroatësh, hungarezësh dhe gjermanë nga Vojvodina u shtetëzuan.

Në fillim të vitit 1944 qeveria e Tiranës i kërkoi Gjermanisë t'i kthen shtetasit shqiptarë që gjinden në Gjermani si robër lufte jugosllav me pretekst që t'i angazhon në luftë me guerilën komuniste. Dhe më 20 maj kërkesa u aprovua dhe të gjithë shqiptarët të cilët ishin me prejardhje nga vendet nën administratën shqiptare u lëshuan në shtëpi me leje pushimi 30 ditë. Dhe pas kësaj të paraqiten në komandaqarkun për udhëzime të mëtutjeshme.

Të gjithë robërit nga Maqedonia, nga fundi i majit zbarkuam në Prizren nga një tren ushtarak, po atë ditë u nisëm për Tetovë nëpër Shar, prej ku të gjithë angazhuam karroca (taksi) dhe u shpërndamë nëpër qytete.

Në komandaqarkun e Dibrës nuk u paraqitëm ngase ato nuk e dinin ku e kishin kokën. Gjermanët ishin të demoralizuar nga lufta që po humbej, me të cilët komunikoja lirshëm dhe shpesh herë u shërbeja për përkthime të rëndësishme. Në fillim të shtatorit 1944 gjermanët tërhiqeshin për në veri. Ditën kur u nisën u përshëndetëm me oficerët që i njihja, njëri prej tyre më la një makinë shkrimi "Oliveti" dhe një pushkë të shkurtër italiane. Nuk më harrohen fjalët të një oficeri fisnik – "Sot e tutje do të jetoni me njerëz që s'dinë çka është ËC". E kishte fjalën për rusët.

Disa orë më vonë në qytet u fut pararoja e brigadës të shtatë sulmuese shqiptare. Në ballë të së cilës ishin të rinjtë dibranë nga Tirana. Flamurin e mbante Xheladin Krifca, i cili më vonë u emërua ambasador në Kinë.

Këshillat nacionalçlirimtare i organizonte kryetari i këshillit të Dibrës, Aqif Lleshi, bashkëfshatar i imi, i cili nuk më mobilizoi për në front me pretekst se gjashtë vjet pa ndërprerje kam qënë ushtar dhe rob lufte. Por, më propozoi dhe zgjodhi kryetar të këshillit nacionalçlirimtar për fshatrat Ame, Krifcë dhe Banisht.

Deri në fund të vitit 1945 brigadat shqiptare kontrollonin Dibrën dhe rrethin. Komandat brigade ishte Haxhi Lleshi, më të cilin ishim moshatarë dhe shokë klase në shkollën fillore sërbishte në vitet 1922-1927. Kur ai mori urdhër të tërhiqet brenda kufijve të 1913 u duk qartë se bashkimi i trojeve shqiptare që aq shumë e kishin propaganduar komunistët ishte fars dhe se shqiptarëve të jasht Shqipërisë londineze u mbetej të mendojnë për një shansë tjetër historike.

Më 1951 Aqif Lleshi para se t'i rrethohet shtëpia ai i informuar prej dikujt kaloi përtej kufirit me afër tridhjetë anëtarë të familjes.

Po atë ditë në të gjithë Dibrën filluan internimet masive, arrestimet, bastisjet, por edhe ekzekutimet në brezin kufitar. Në Veles dhe Shtip u internuan rreth 60 familje, pronat e të cilëve iu bashkuan kooperativës me gjithë kafshë. Pleqtë, të sëmurët dhe shumë fëmijë vdiqën nga uria, ethet dhe tuberkulozi. Internimet zgjatën prej tre deri gjashtë vjet. Dibra në Veles dhe Shtip la shumë varre.

I ashtuquajturi revolucioni socialist në Dibër ka lënë plagë të pashërueshme më shumë se çdo qytet tjetër shqiptar".

"Nga Dibra në gjermani kishte edhe robër të tjerë të luftës, - *shton Xha Mirto,* - si: Nazif Mashkulli, Shefki Strikçani, Xhetan Kaja, Kareman Sela, Hisni Strikçani, Elmaz Duka, Hisni Markja, Kalosh Lleshi, Osman Shehu, Bajram Frangu, Aki Tollumi, etj."

Shënimet tona nuk kanë të ndalur ata do ti mbeten historisë. Qëllimi i këtij shkrimi, me rastin e trevjetorit të vdekjes së Mirto Qormemetit, ritushon që përmes robit të fundit të Luftës së Dytë Botërore të prezantohet pjesërisht dhimbja dhe vuajtja e popullit të këtij nënqielli.

traditë

Kënga e Rexhës është shumë e përhapur. **Teza mbi origjinën e saj** dhe rrjedhimisht edhe vendlindja e baladës. A është Kalaja e Dodës, katundi Radomirë, vendi ku ka ndodhur tragjedia?

Në gjurmët e një balade

Nga **JAHE DELIA (SELMANI)**

Treva e Kalasë së Dodës është e njohur për pasuri të madhe folklorike. Në repertorin e shumtë të interpretuesve të kësaj krahine zënë një vend të rëndësishëm këngët e vallet. Pa u zgjatur shumë për këtë pasuri, e cila kërkon kohë për një studim më të gjatë, nëpërmjet këtij shkrimi desha të bëj objekt të dhënat për një baladë aq të njohur në të gjitha viset tona. Balada, si gjini epike-lirike, ka qenë dhe mbetet shumë e dashur, e afërt dhe komunikuese me ndjenjat e popullit tonë. Në shekuj janë krijuar e kënduar mjaft balada, ku lirikja dhe epikja, të pleksura ngushtë, e kanë bërë të dallueshme nga këngët e llojeve të tjera. Ne sot do të ndalemi pikërisht tek kënga e Rexhës. Megjithëse e veçantë, për sa i takon subjektit të saj, ajo mori një përhapje shumë të gjerë gjeografike. Kaq e përhapur është bërë, saqë shumë zona brenda kufijve tanë, por dhe jashtë ku ka shqiptarë, këtë baladë e kanë bërë pronë të tyre. Këtë baladë si dhe mjaft të tjera i krijoi dhimbja e popullit, në rastin konkret, tragjedia që shkaktoi vdekja e djalit ditën e dasmës së tij. Për këtë perlë të krijuar nga një dhimbje konkrete është folur me të drejtë aq shumë. Nuk është rast unik në llojin e vet vetëm subjekti i thjeshtë, pa hyrje e dalje, por edhe sinteza e dhimbjes që nderet në çdo fjalë. E tëra është kulm i dhimbjes tragjike. Mendimet e mia nuk shprehin ndonjë gjë të re për këtë krijim dinjitoz të popullit, por ajo që na bën të themi diçka tjetër: vendndodhja e ngjarjes e rrjedhimisht edhe vendlindja e baladës, që është padyshim Kalaja e Dodës, katundi Radomirë. Me të drejtë dikush mund të mendojë se vënia e disa kontureve gjeografike e kohore, siç do të shohim më poshtë, e bën më të rëndomtë ngjarjen dhe jo aq të ndjeshme dhimbjen që shpreh. Me dashamirësi përgjigjemi se s'është ky qëllimi im, por diçka më shumë. Edhe pa këto që po shprehim, ajo e ka gjetur vendin në gjerdanin rrezullues të pasurisë së pafundme folklorike, ajo është pronë e të gjithëve, secili që e dëgjon apo e këndon gjen diçka nga vetja, i lë hapësirë drithëruese fantazisë së tij. E megjithatë e shohim me vend të sqarojmë pse mendojmë që vendlindja e saj e parë nga u përhap është Radomira. Sigurisht që gjë të shkruar për këtë nuk ka dhe as pritet të ketë kur bëhet fjalë për një baladë. Në kujtesën e popullit mbeten sentimentet e saj të përgjithshme e jo hollësi të tilla si vendi apo koha që ose nuk përmenden ose përmenden shkarazi. Tri janë arsyet që na bëjnë të mbështesim mendimin e mësipërm: Së pari: tek dëshmitë e disa të moshuarve edhe ata të marra nga transmetimet e para ardhësve të tyre. Kur e dëgjonte këtë këngë i moshuari V.Gj., vdekur para 30 vjetësh në moshën 90 vjeç, me përmallim u drejtohej njerëzve: "Ah, more djem, kjo ngjarje ka ndodhur në këtë vend!" dhe tregonte gojarisht atë dhe themelet e shtëpisë. Të moshuarit nuk habiteshin, se dhe ato shprehnin të njëjtin mendim, kurse ne të rinjtë e atëhershëm ndiheshim krenarë. Fisi Rroshi, ku mendohet se ndodhi drama, ka qenë me shumë ndikim për pasuri, por edhe për punë të dobishme që bënte për vetë popullin e krahinës.

Sipas dëshmive ky fis u shpërngul nga ky katund afro 250 vjet më parë, edhe kënga duhet të jetë afërsisht e kësaj moshe. Dëshmohet gjithashtu që në Misir ku emigroi, ai krijoi një fshat të tërë me emrin Radomirë. Për këtë fis ka edhe gojëdhëna të tjera interesante, me të cilat nuk është e udhës të zgjatemi në këtë shkrim. Së dyti që hedh dritë dhe vërteton vendndodhjen e ngjarjes tek ky vend e tek ky fis është edhe letërkëmbimi që është ruajtur nga një pasardhës i këtij fisi nga Misiri me emrin Rexhë Rroshi, me të afërm të tij në lagjen Tejs-Radomirë deri 40 vjet më parë. Ky emër është padyshim emri i Rexhës së këngës të trashëguar në atë familje. Argumenti i tretë në mbrojtje të mendimit tonë është teksti dhe melodia e baladës. Melodia e gjetur vitet e fundit, me ndryshim nga ajo që njohim të gjithë është një tregues tjetër për origjinalitetin e saj dhe kjo u bë një nxitje më shumë për hulumtimin tonë. Ndërtimi melodik i vargut kalon nga 10 rrokësh në strofë në 12 rrokësh në interpretimin e dy vargjeve të para, për të kaluar pastaj në 8 rrokësh në refren. Kjo thyerje në tekst e në melodi të shkund, të trondit e të ngjeth tërë qenien. Teksti përfshin vargjet e asaj që njihen nga të gjithë, por ka dhe disa strofa që besojmë se ende nuk njihen. Ndërtimi i këtyre vargjeve plus melodinë bëjnë një variant tjetër të këngës, pa ndryshuar thelbin tragjik të ngjarjes. Në vargjet që mendojmë se janë të paekspozuara, drama është më e prekshme dhe kjo shprehet nëpërmjet disa kontrasteve tepër të fuqishme.

Momenti kur dasma ka arritur kulmin dhe shokët e heroit të baladës hedhin valle (kcejnë në kurt-oborr), kur motrat "hekin hore" (modeli më i përhapur i valles së grave dhe vajzave të krahinës), krijuesi popullor i kundërvë nënën, me stoicizmin e paimagjinueshëm, tipike për një nënë shqiptare, e cila akoma ruan të fshehur të vërtetën e kobshme. Radhisim strofat:

"Shokët e Rexhës po na kcejnë në kurt-e
Po Rexha i nanës palë në tabut-e
Çou Rexho, çou o biro...
Shokët e Rexhës po qesin fishekë,
po Rexha i nanës palë në dyshek,
Çou Rexho, çou o biro...
Motrat e Rexhës po na hekin hore,
Po Rexhën e nanës do ta çojnë në vorre,
Çou Rexho, çou o biro...
Ç'pate, more Rexho, që shkove te kepi,
Nusja jote, biro, posi nuse mreti,
Çou Rexho, çou o biro...
Ç'pate more Rexho që shkove te Çili,
Nusen tane bir e muer Haxhi Zeqiri,
Çou Rexho, çou o biro..."

Siç shihet, në tekst na del edhe një emër. Sigurisht që nusja e pafajshme nuk do të rrinte pa u martuar, ndoshta me emrin e përmendur në baladë, por ky emër nga krijuesi popullor duket sikur përdoret për t'i vënë një kapak më të rëndë tragjedisë së ndodhur: si u nis dasma e djalit të vetëm e si përfundoi. Djali u vra kur po merrte kalin e tij, sigurisht për të marrë pjesë në garat burrërore me kuaj që zhvilloheshin me këtë rast në një vend të caktuar mbi fshat. Garat në raste gëzimesh kanë qenë pjesë e jetës së këtij komuniteti deri në vitin 1912, në një vend të caktuar ku fituesin e priste në finishin e vendmbërritjes së kalit më të shpejtë, një dash i zbukuruar dhe përgëzimet e turmës. Erdhi pastaj viti me djegiet, vrasjet e persekutimet serbe dhe u ndërprenë edhe këto gara me kuaj që ishin traditë e kahershme në të gjithë Kalanë e Dodës. Kënga e nisur nga një ngjarje reale shpejt mori përhapje. Në një nga zonat fqinje, besojmë se u përhap edhe në Kosovë e në vise të tjera. Duhet të theksojmë pra se kjo baladë nuk është krijim i fantazisë, është fiksimi artistik i një momenti kulmor tragjik.

Otranto, Port i Dhimbjes dhe Shpresës

Kushtuar të rënëve të Dibrës, viktima të Otrantos.

Një fjongo të kuqe ia vura detit
Mbi kaltërsi dallgësh
dhimbja e kuçedra m'u shfaq.

Një nënë dibrane mes odës lëshon piskamën
Kurorë e blertë
s'ka e s'ka duar foshnjërisht ta mbajë.
Një foshnje luan symbyllur me vdekjen
Nga gji i ftohtë thith jo tambël, por gjak.
Baladë vërtet e gjallë.
Dramë e tragjedi moderne me valle vdekjen mbi dallgë.

Një burrë krahët zgjat
e nuk mundet të ndihmojë vëllanë sadopak.
Otranto e Zezë.
Ti, Port i Dhimbjes, ti, Port i Shpresës, ti, Port i Valëve.
S'e dinim që më ëndërr makabre
do të na shfaqeshe një ditë, një çast.

Otranto e zezë.
Otranto e blertë që na veshe në zi.
Për vdekjen u ktheve në djep
Oi...oi...oi...

Pas nëntë malesh
Kullë më kullë Dibra mortin dhëmbështrënguar e hap.
Këngëligjet
me çarçafë të zinj bjeshkët e dheun e ugarit mjegullojnë.
E marsi i Otrantos
lule rudine, e gjeth, e drurë gjer në palcën e rrënjës i than.
E valët e Shpirtit
brigje të rinj këngësh symbyllur kërkojnë e kërkojnë.

Pranverë me lule mollësh
donin të na i linin me Dimrin nga mot përqafuar.
Në ca udhë mërgimtare
mbi Fushë të Korabit u rizgjoka malli i patretur
Bëjeni një lapidar të blertë
në mes të detit, me stërkala ëndrrash plaguar si zjarr i pashuar.
Në librin e Historisë dibrane
Monumentit të kujtesë le t'i përulemi dhe sot dhe nesër.

O zot, mos më keq!
Mos të pafsha më, o Ditë e marsit në Otranto!

Namik Selmani, shkrimtar

Shkruajnë lexuesit

"Sul Peka, krenaria e Lurës"

"Në vitin 1908 Turqia mori nizamët e parë në zonën e Lurës. Mes tyre, edhe Sul Pekën. Shumica prej tyre nuk u kthyen më në vatrat e tyre. Mbas disa vitesh ushtarët kanë komunikuar me anë korrespondence me familjet e tyre nga Turqia në Shqipëri. Këtyre u janë bërë letrat nga njerëz me shkollë, sepse ishin të pashkolluar edhe neve letrat e tyre i lexonim nëpërmes hoxhallarëve e prift-ërinjve. Më vonë u ndërpre ndërlidhja. Ardhja e disa burrave pas shumë vitesh deklaruan se gjatë luftës u është ndërpre ndërlidhja dhe nuk dimë asgjë për jetën e tyre. U deklaruan të vdekur. Për këtë arsye, ceremonia e varrimit të Sul Pekës u bë pa kufomë, ashtu si dhe shume nizamëve të tjerë.

Por, rreth viteve 1982-1984, në Tiranë vjen një grup folklorik nga Turqia. Në atë koncert, takova një burrë nga Korça, i cili ishte pjestar i ansamblit turk, i ikur herët nga Shqipëria. Ai kur mori vesh se mbaja emrin e Gjyshit, më shpjegoi se njihte një person nga Shqipëria, që duhej Sul Peka dhe jetonte në Stamboll. Më dha adresën dhe unë i shkrova me shpresë. Por letrat nga adresa "Nisam Xhadedesi Nr.24, Kërtall Istambul Turçi" më janë rikthyer me shënimin "adresa gabim".

Sipas informatave jo të sakta, Sul Peka i Lurës, shkuar nizam në Turqi në vitin 1908, ka vdekur në Stamboll në vitin 1986. Ka lënë 2 djem, por ne nuk kemi mundur të kemi asnjë lidhje me të. Në respekt të tij, ju lutem botoni këtë poezi, shkruar me dashuri nga Haki Koltraka".

Faleminderit,
SUL PEKA, nipi i Sul Pekës së Stambollit

HAKI KOLTRAKA: POEZI KUSHTUAR SUL PEKËS

Karakoll në histori Lura
Krye vendi me besë, burra
Ky Sul Peka kësulën në sy
Rreth brezit me dy allti
Vepra të nalta bëjnë djemtë e mi
Vepra të nalta ka ba Lura
E ka vendin në valle me burra.
Ky Sul Peka i stopanit
Djemtë e mi roje vatanit
Sa të jetë jeta ball istikamit
Brez pas brezi djalë pas djalit
Ky Sul Peka kësulën në sy
Ngjeshur brezit dy allti
Ndan kanun me drejtësi
Në nantë male është përmbi.
Ky Sul Peka i karakollit
Karshillëk i bën Stambollit
Karshillëk i bën Serbisë
Kërkon trojet e Shqipërisë.
Ky Sul Peka kësulën në sy
Ngjeshur brezit dy allti
Është për Lurën krenari
Krenari për Shqipëri.

Artemisa Repa *dhe* **Fatrin Krajka** *dhanë një koncert më 24 qershor.*
Dy dibranët u duartrokitën *gjatë nga spektatorët*
që kishin mbushur sallën në Akademinë e Arteve.

Artemisa Repa, sopranoja dibrane që ka pushtuar skenën europiane



Artemisa Repa dhe Fatrin Krajka dhanë një koncert më 24 qershor. Dy dibranët u duartrokitën gjatë nga spektatorët që kishin mbushur sallën në Akademinë e Arteve.

Fatrin Krajka ishte i pari që hapi koncertin, duke luajtur në piano melodi nga Gluck, Liszt, Copland, Scriabin, ndërsa sopranoja Artemisa Repa këndoi arie nga Bellini, Vivaldi, Puccini.

Ndërsa për Fatrinin ky ishte koncerti i parë në Shqipëri, për Artemisën nuk ishte i tillë. Ajo ka kënduar edhe herë të tjera në Shqipëri, ku më i rëndësishmi është festivali ndërkombëtar "Marie Kraja", ku ka fituar çmim në vitin 2004.

Koncerti i 24 Qershorit ishte shumë i rëndësishëm për Artemisën, pasi ajo vinte nga një premierë muajin e kaluar në Operan e Stambollit me "Romeo e Zhuljeta". Këtë sukses ajo ia përcolli edhe publikut shqiptar më 24 qershor, ku nga 4 arie në program, njëra ishte nga premiera e Stambollit.

"Emocionet dhe përgjegjësia që përcjell tek publiku shqiptar janë të jashtëzakonshme. Nga ana profesionale i jam mirënjohëse shkollës shqiptare të kantos, e cila është evidentuar dhe në botë, nga ku mjaftë artistë tanë kanë bërë emër", - thotë Artemisa. Ndërsa puna me mjeshtër të muzikës klasike, në Romë, Gjermani dhe Stamboll më kanë shtuar sigurinë dhe teknikën interpretuese".

Vlerat artistike të Artemisës janë vlerësuar shumë edhe në shtypin botëror. "Sopranoja e re Artemisa Repa ka marrë pjesë në shumë konkurse në Shqipëri, Itali dhe Gjermani, ku ka fituar dhe çmime. Zëri i saj është i fortë dhe ka mjaft ngjyra, e dalë nga një grua e mrekullueshme,

"Do të ishte një ngjarje e veçantë për mua, që të jepja një koncert me pjesë të zgjedhura klasike, por dhe muzike të përpunuar dibrane në evenimentin e përurimit të Rrugës së Arbërit. Do të ishte me interes që soliste dhe muzikantë si Bashkim Pacuku, Arif Vladi, Liri Rasha, Isak Shehu e të tjerë të përfshiheshin në këtë eveniment"

duke sjellë një surprizë në Opera", shkruan shtypi turk. "Artemisa ka një zë melodioz dhe të veçantë"- vlerësonë mediat në Gjermani dhe Itali.

Në një intervistë për RTSH Zhani Ciko e vlerësoi lart Artemisën si nga ana e teknikës, ashtu dhe nga ana e muzikalitetit në interpretim.

Pyetjes për planet e saj të ardhshme, ajo përgjigjet: "Kam në projekt që nga shtatori në Teatrin e Operas në Romë të mbaj një koncert me arie nga kolosët e muzikës klasike si Verdi, Rossini, Belini, etj."

Përveç sukseseve në operat botërore, të cilat, me talentin që ka Artemisa do të jenë të shpejta e të shpeshta, ajo kërkon edhe një sukses tjetër në Shqipëri. Dhe jo vetëm në ariet e mrekullueshme që këndon.



ARTEMISA REPA, *soprano. E diplomuar në vitin 2002 me notë maksimale pranë Akademisë së Arteve të Tiranës, është specializuar në vitin 2006 pranë Conservatorio di Musica "S. Cecilia" në Romë, ku është klasifikuar e para në mes e mëse njëqind këngëtarëve nga kombësi ndryshme.*

Fituese e konkurseve të shumtë ndërkombëtarë, mes të cilëve Col1corso Internazionale "G. Rossini" në Wildbad (2003), Concorso Lirico "En'ico Caruso" në Milano (2004), Concorso Internazionale "Martinelli-Pertile" në Montagnana (2004), Concorso Internazionale "Zandonai" në Riva del Garda (2004), Konkursin Ndërkombëtar "Marie Kraja" në Tiranë (2004).

Ka ndjekur masterclass-e ne kanto me Mirella Freni, Raina Kabaivanska, Katia Ricciarelli, Mietta Sighele, Giovanna Canetti.

Aktualisht studion me Mjeshtren Marinella Meli a Roma dhe Elisabetta Di Stefano në Stamboll.

*Ka marrë pjesë si soliste në koncerte të shumtë në Itali dhe vende të tjera në salla të famshme si Auditorio Santa Cecilia del Parco della Musica a Roma (2004) apo në Kishen e Shen Irenes ne Stamboll(2007) -dhe ka interpretuar role te ndryshme ne opera, mes të cilave Serpina **ne La serva padrona** te Pergolesi (2001), Carolina ne **Il matrimonio segreto** te Cimarosa (2001), Lucy ne **Il telefono** te Menotti (2003), Giulia ne **La scala di seta** te Rossini (2003), Giulietta ne **Capuleti e Montecchi** te Belini, ne nje produksion te koheve te fundit te Teatrit te Operes se Stambollit (mars 2008).*

Ajo ka peng që nuk viziton dot vendin e saj të origjinës, Dibrën, por shpreson këtë ta bëjë shpesh kur të kemi Rrugën e Arbërit. Dhe këtë, në një mënyrë shumë simbolike. "Do të ishte një ngjarje e veçantë për mua, që të jepja një koncert me pjesë të zgjedhura klasike, por dhe muzike të përpunuar dibrane në evenimentin e përurimit të Rrugës së Arbërit. Do të ishte me interes që soliste dhe muzikantë si Bashkim Pacuku, Arif Vladi, Liri Rasha, Isak Shehu e të tjerë të përfshiheshin në këtë eveniment. Besoj se kjo ditë nuk do jetë e largët, por për këtë duhet menduar që tani".

Korresp. i "Rruga e Arbërit"

PAJTOHUNI NË GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT"

Pajtimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat: Cel: 068 31 19 232 ose në numrin fiks 22 33 283.
Pajtimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë "Fleta XXI", pranë Gjimnazit "Said Najdeni", me nr. tel: 0218 4233.
Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

- KËRKOHEN KORRESPONDENTË NE RRETHET DIBËR, LEZHË, DURRËS.

- BENI NJOFTIMIN TUAJ TE BIZNESIT

Bëhuni pjesë e gazetës!

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
www.**dibra**.org

Bar - Restorant
"PËLLUMBAT E PAQES"
vë në dispozicion mjediset e saj për festa familjare, dasma, ditëlindje, kokteje, etj.

Mjedise fantastike, të bollshme dhe kuzhinë tradicionale.

Sigurojmë DJ për gëzimet tuaja!

Adresa: "Myslim Keta", Tiranë
Tel. 068 20 80 517

Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **2233 283**.